# REPUBLIKA E SHQIPERISË
# AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

Open Procurement Albania

# DOKUMENTAT STANDARDE TË PROCEDURËS SË HAPUR
# SHËRBIME

**Objekti: "Ruajtja e godines me roje private" – Marreveshje Kuader - me nje operator ekonomik ku te gjitha kushtet jane te percaktuara - me afat 12 muaj.**

**Fondi i Marrveshjes Kuader per 12 muaj - 8.102.951,68 (tete milion e njeqind e dy mije e nenteqind e pesedhjete e nje leke e gjashtedhjete e tete qindarka)**

**Fondi limit/MUJOR- 675.245,97 (gjashteqind e shtatedhjete e pese mije e dyqind e dyzet e pese leke e netedhjete e shtate qindarka pa TVSH)**

# I . NJOFTIMI I KONTRATES

## Seksioni 1. Autoriteti Kontraktor

**1.1 Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor**

| | |
|---|---|
| Emri | **Anxhela Kostandini – person pergjegjes**<br>**S.U.O.GJ "Mbreteresha Geraldine"** |
| Adresa | **Blv. Zog i I-re, Tirane** |
| Tel/Fax | **0692491916** |
| E-mail | **angel_818551@yahoo.com** |
| Faqja e Internetit | **www.suogjgeraldine.gov.al/** |

**1.2 Lloji i autoritetit kontraktor:**

Institucion qendror     Institucion i pavarur

Njesi e qeverisjes vendore     Tjeter +

**1.3 Kontrate ne kuadrin e nje Marreveshjeje te veçante ndermjet Shqiperise dhe nje Shteti tjeter**

Po     Jo +

Open Procurement Albania
Public Health Sector

## Seksioni 2 Objekti i kontrates

**2.1Numri i references se procedures/lotit REF-62400-04-13-2018**

**2.2 Lloji i "Kontratave Publike per Sherbime"**

**Konkurs Projektimi**     **Sherbime Konsulence**     **Sherbime te tjera** +

**2.3 Kontrate ne baze te Marreveshjes Kuader**

Po +     Jo

**2.4 Lloji i Marreveshjes Kuader**

**Me nje Operator Ekonomik** +
**Me disa operatore ekonomike**
**Te gjitha kushtet jane te percaktuara Po** + **Jo**

**2.5 Numri i operatoreve ekonomike me te cilet do te perfundoje Marreveshja Kuader: 1(nje) (*Ketu duhet te percaktohet numri maksimal i operatoreve ekonomike me te cilet do te lidhet Marreveshja Kuader*).**

| | | |
|---|---|---|
| **2.6** | Kushtet qe do zbatohen ne rastin e rihapjes se konkurimit dhe/ose perdorimi i mundshem i blerjes elektronike | **Nuk do të ketë rihapje të konkursit.**<br>**Kontratat do të lidhen sipas kerkesave te AK, me operatorin ekonomik me te suksesshëm, i cili do te ofroje cmimin me te ulet per nje vendroje per nje muaj.**<br>**Dhënia e kontratave do të behet nga S.U.O.GJ Mbreteresha Geraldine.** |

**2.7 Autoriteti kontraktor / Autoritetet kontraktore, te cilat do te lidhin marreveshjen kuader: S.U.O.GJ Mbreteresha Geraldine**

**2.8 Pershkrim i shkurter i kontrates/marreveshjes kuader**

1. Fondi limit: **8.102.951,68 (tete milion e njeqind e dy mije e nenteqind e pesedhjete e nje leke e gjashtedhjete e tete qindarka); Fondi limit/MUJOR - 675.245,97 (gjashteqind e shtatedhjete e pese mije e dyqind e dyzet e pese leke e netedhjete e shtate qindarka pa TVSH)**
2. Burimi i Financimit: **Buxheti i shtetit**
3. Objekti i kontrates/marreveshjes kuader: **Sherbimi me roje private SH.P.S.F. Marreveshje Kuader - me nje operator ekonomik ku te gjitha kushtet jane te percaktuara - me afat 12 muaj**

**2. 9 Kohezgjatja e kontrates ose afati kohor per ekzekutimin:**

Kohezgjatja ne **muaj ose dite**

ose

duke filluar nga // me perfundim ne //

2.9.1 Kohezgjatja e Marreveshjes Kuader

**Kohezgjatja ne muaj: __12 muaj__** *ose* **dite: (nga nenshkrimi i Marreveshjes Kuader***(jo me shume se (4) vjet***)**
*Ose* **duke filluar nga // (dd/mm/vvvv)**
**Perfunduar me // (dd/mm/vvvv)**

**2.10 Vendi i kryerjes se sherbimeve, objekti i kontrates/marreveshjes kuader:**
**__S.U.O.GJ Mbreteresha Geraldine, Blv Zog i I-re, Tirane__**

**2.11 Ndarja ne Lote:**

Po Jo +

*Nese po,*

**2.12 Pershkrim i shkurter i loteve**

(Objekti dhe fondi limit i loteve)
1____________________________________________________________
2.___________________________________________________________
3.___________________________________________________________
etj.

Open Procurement Albania

Nje Ofertues mund te aplikoje per [nje lot], [disa lote], [te gjitha lotet]. Per çdo lot paraqitet nje oferte e veçante.

**2.13 Opsionet:**

Numri i rinovimeve te mundshme *(nese ka)*: **JO**

Public Health Sector

Ose: nga ne

**2.14 Do te pranohen variantet:**

Po Jo +

**2.14.1 Do te pranohet nenkontraktimi:**

Po Jo +

**Nese do te lejohet nenkontraktimi,** te specifikohet perqindja e lejuar per nenkontraktim: ____

Autoriteti kontraktor do t'i beje pagesa te drejperdrejte nenkontraktorit:

Po Jo +

**Shenime te tjera**

______________________________________________________________________
______________________________________________________________________
______________________________________________________________________

**2.15. Gjate procesit te prokurimit ne fushen e Teknologjise te Informacionit dhe Komunikimit (TIK) jane perdorur standartet e pergatitura nga Agjencia Kombetare e Shoqerise se Informacionit:**

Po Jo +

**2.16. Gjate procesit te prokurimit ne fushen e Teknologjise te Informacionit dhe Komunikimit (TIK), ne rastin kur standardet jane te pa-aplikueshme, eshte marre miratimi paraprak nga Agjencia Kombetare e Shoqerise se Informacionit:**

Po Jo +

**Seksioni 3** **Informacioni ligjor, ekonomik, financiar dhe teknik**

Open Procurement Albania Public Health Sector

**3.1 Kriteret e Pranimit sipas Shtojces 8**

**3.2 Sigurimi i Ofertes[1]: (** i zbatueshem ne rastin e procedurave te prokurimit me vlere me te larte se kufiri i larte monetar, ne rast se kerkohet nga autoriteti kontraktor**)** Operatori Ekonomik paraqet Formularin e sigurimit te ofertes, kur kerkohet, **sipas Shtojces 3**. Vlera e kerkuar e sigurimit te ofertes eshte __________ Leke (shuma e shprehur ne fjale).

Ne rastet e dorezimit te ofertes per Lote, vlera e sigurimit te ofertes, kur kerkohet, per secilin nga Lotet eshte si me poshte:
Loti 1 _______ Leke
Loti 2 _______ Leke

**Seksioni 4** **Procedura**

**4.1 Lloji i procedures:** E hapur

Procedure prokurimi e rishpallur
Po Jo +

Nese eshte procedure e rishpallur te plotesohen te dhenat identifikuese te procedures se anuluar:

a) Numri i references ne sistemin e prokurimit elektronik te procedures se prokurimit te anulluar

b) Objekti i prokurimit te procedures se prokurimi te anulluar ____________________________

c) Fondi limit i procedures se prokurimit te anulluar ____________________________________

**4.2 Kriteret e perzgjedhjes se fituesit:**

A) **çmimi me i ulet** +

*Ose*

B) **oferta ekonomikisht me e favorshme**

lidhur me rendesine: Çmimi **pike**

etj. **pike**

Autoriteti Kontraktor duhet te specifikoje piket per çdo kriter vleresimi te vendosur.

**4.3 Afati kohor per dorezimin e ofertave ose kerkesave per pjesemarrje:**

Data: **14/05/2018** *(dd/mm/vvvv)* **Ora: 11:00**

Vendi: www.app.gov.al

Open Procurement Albania

**Kur oferta kerkohet te paraqitet me mjete elektronike operatoret ekonomike duhet te dorezojne oferten ne menyre elektronike ne faqen zyrtare te APP-se, www.app.gov.al**

**4.4 Afati kohor per hapjen e ofertave ose kerkesave per pjesemarrje:**

Data: **14/05/2018** *(dd/mm/vvvv)* **Ora: 11:00**

Vendi: www.app.gov.al

Public Health Sector

**Informacioni mbi ofertate paraqitura me mjete elektronike duhet t'i komunikohet te gjithe atyre Operatoreve Ekonomike qe kane dorezuar oferta, ne baze te kerkeses se tyre.**

**4.5 Periudha e vlefshmerise se ofertave: 150** *(ne dite)*

**4.6 Gjuha (-et) per hartimin e ofertave ose kerkesave per pjesemarrje:**

Shqip + Anglisht

Tjeter ________________

**Seksioni 5** **<u>Informacione plotesuese</u>**

**5.1 Dokumenta me pagese (i zbatueshem vetem per procedurat qe nuk zhvillohen me mjete elektronike):**

Po Jo +

*Nese Po*

Monedha _________ Çmimi _______

Ky çmim mbulon kostot aktuale te kopjimit dhe shperndarjes se DT tek Operatoret Ekonomike. Operatoret Ekonomike te interesuar kane te drejte te kontrollojne DT para blerjes se tyre.

**5.2 Informacione shtese (vendi, zyra, menyrat per terheqjen e dokumentave te tenderit)**

______________________________________________________________

______________________________________________________________

______________________________________________________________

Data e shperndarjes se ketij njoftimi **16/04/2018**

**Njoftimi i kontrates per t'u plotesuar nga Autoriteti Kontraktor, i cili do te publikohet ne**

**Buletinin e Njoftimeve Publike**

**1. Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor**

| | |
|---|---|
| Emri | **Anxhela Kostandini – person pergjegjes** |
| | **S.U.O.GJ "Mbreteresha Geraldine"** |
| Adresa | **Blv. Zog i I-re, Tirane** |
| Tel/Fax | **0692491916** |
| E-mail | **angel_818551@yahoo.com** |
| Faqja e Internetit | **www.suogjgeraldine.gov.al/** |

**2. Lloji i procedures se prokurimit: Marreveshje Kuader - me nje operator ekonomik ku te gjitha kushtet jane te percaktuara - me afat 12 muaj**

**3. Objekti i kontrates/marreveshjes kuader: Sherbimi me roje private SH.P.S.F. Marreveshje Kuader - me nje operator ekonomik ku te gjitha kushtet jane te percaktuara - me afat 12 muaj**

Open Procurement Albania
Public Health Sector

**4. Numri i references se procedures/lotit REF-62400-04-13-2018**

**5. Fondi limit: 8.102.951,68 (tete milion e njeqind e dy mije e nenteqind e pesedhjete e nje leke e gjashtedhjete e tete qindarka); Fondi limit/MUJOR - 675.245,97 (gjashteqind e shtatedhjete e pese mije e dyqind e dyzet e pese leke e netedhjete e shtate qindarka pa TVSH)**

**6. Kohezgjatja e kontrates ose afati kohor per ekzekutimin: 12 Muaj**

**7. Afati kohor per dorezimin e ofertave ose kerkesave per pjesemarrje: 14.05.2018 ora 11:00**

**8. Afati kohor per hapjen e ofertave ose kerkesave per pjesemarrje: 14.05.2018 ora 11:00**

## II. UDHEZIME PER OPERATORET EKONOMIKE

**Seksioni 1. <u>Hartimi i ofertes</u>**

1.1 Operatoret Ekonomike jane te detyruar te pergatisin oferta, ne perputhje me kerkesat e percaktuara ne keto DT. Ofertat qe nuk pergatiten ne perputhje me keto DT do te refuzohen si te papranueshme.

1.2 Operatori Ekonomik perballon kostot qe lidhen me pergatitjen dhe dorezimin e ofertes se tij. Autoriteti Kontraktor nuk eshte pergjegjes per keto kosto.

1.3 Per procedurat e prokurimit qe zhvillohen ne rruge shkresore, origjinali i ofertes duhet te shtypet ose te shkruhet me boje qe nuk fshihet. Te gjitha fletet e ofertes duhet te lidhen se bashku dhe te numerizohen. Te gjitha fletet e ofertes, perveç literatures se pandryshueshme e te printuar duhet te pajisen me iniciale ose te nenshkruhen nga Personi (-at) e autorizuar. Çdo ndryshim ne oferte duhet te jete i lexueshem dhe i firmosur nga Personat e Autorizuar.

1.4 Ne rast te ofertave te paraqitura nga nje bashkim operatoresh ekonomike, oferta duhet te shoqerohet me Prokuren/autorizimin me Shkrim per Personat e Autorizuar qe do te perfaqesojne bashkimin gjate procedures se prokurimit.

Open Albania
Public Health Sector

1.5 **Oferta duhet te perfshije dokumentat e meposhtem:**

a) Formulari i Ofertes Ekonomike, plotesuar **sipas Shtojces 1 te DT.**

b) Dokumentat qe lidhen me objektin e prokurimit (*skica, katalogje, kampione etj*)
___________ ,
___________ ,
___________ .

c) Dokumentat dhe vertetimet e kerkuara **ne Shtojcen 7**

ç) (Opsion) oferten alternative teknike (nese parashikohet)

Nje Operator Ekonomik duhet te paraqese vetem nje oferte.

1.6 Fshehtesia e procesit sipas nenit 25 te LPP-se.

1.7 Per procedurat e prokurimit qe zhvillohen ne rruge shkresore, Operatoret Ekonomike duhet te dorezojne vetem oferten origjinale te futur ne nje zarf jotransparent, te mbyllur, te vulosur dhe firmosur me emrin dhe adresen e Ofertuesit dhe te shenuar: “Oferte per kryerjen e __________sherbimeve; Nr e Njoftimit _______________
**“MOS E HAPNI, ME PERJASHTIM TE RASTEVE KUR ESHTE I PRANISHEN KOMISIONI I VLERESIMIT TE OFERTES, DHE JO PARA ___________ (dd/mm/vv) ores ______”.**

**Kur oferta kerkohet te paraqitet me mjete elektronike, operatoret ekonomike duhet te dorezojne oferten ne menyre elektronike ne faqen zyrtare te APP-se, www.app.gov.al.**

1.8 Per procedurat e prokurimit qe zhvillohen ne rruge shkresore, ofertuesit mund te modifikojne ose te terheqin ofertat e tyre, me kusht qe ky modifikim ose terheqje te kryhet para afatit kohor perfundimtar per paraqitjen e ofertave. Si modifikimet, ashtu edhe terheqjet duhet t'i komunikohen Autoritetit Kontraktor me shkrim para dates se fundit per dorezimin e ofertave. Zarfi qe permban deklaraten e Ofertuesit duhet te shenohet perkatesisht: **"MODIFIKIM OFERTE"** ose **"TERHEQJE OFERTE".**

**Kur oferta kerkohet te paraqitet me mjete elektronike, ofertuesi mund te modifikoje ne çdo kohe oferten deri perpara perfundimit te afatit kohor per dorezimin e ofertave, pa patur nevoje per ndonje komunikim me autoritetin kontraktor, pasi veprimet kryhen ne llogarine e tij, ne faqen zyrtare te APP-se, www.app.gov.al.**

**Seksioni 2 Perllogaritja e ofertes ekonomike**

2.1 Operatori Ekonomik duhet te plotesoje Formularin e Ofertes Ekonomike bashkangjitur me keto DT, duke percaktuar sherbimet qe do te ekzekutohen dhe çmimin e tyre.

2.2 Te gjitha çmimet duhet te kuotohen ne Monedhen Shqiptare (Lek), duke perfshire edhe tatimet qe zbatohen, por pa perfshire TVSH. Nese çmimet kuotohen ne nje monedhe te huaj, atehere ato duhet te kthehen ne Leke Shqiptare sipas kursit zyrtar te kembimit te Bankes se Shqiperise, ne daten ne te cilen eshte derguar per publikim njoftimi i kontrates dhe duhet te ruhen ne ate kurs deri ne skadimin e periudhes se vlefshmerise se ofertes.

2.3 Ofertuesi duhet te shenoje ne Formularin e Ofertes Ekonomike, çmimet totale te ofertes te te gjitha Sherbimeve, pa TVSH. Vlera e TVSH, kur aplikohet, i shtohet çmimit te dhene dhe perben vleren totale te ofertes.

2.4. Ne rastin e nje marreveshje kuader ku te gjitha kushtet NUK jane percaktuar, çmimet per kontratat e bazuara ne marreveshjen kuader nuk jane te fiksuara; ato jane objekt i ndryshimit pas nje mini-konkurrimi midis operatoreve ekonomike, pale ne marreveshjen kuader.

2.5 Sigurimi i Ofertes, kur kerkohet, duhet te dorezohet bashke me oferten para skadimit te afatit kohor per dorezimin e ofertave. Mospajtimi me kerkesat per sigurimin e ofertes do te kete si pasoje refuzimin e ofertes.

2.6 Sigurimi i Ofertes, kur kerkohet, mund te dorezohet ne nje nga format e meposhtme:

a) garanci bankare
b) garanci sigurimi

Formulari i sigurimit te ofertes duhet te nenshkruhet nga leshuesi (Banka, kompania e sigurimit, etj) dhe duhet te dorezohet se bashku me oferten para hapjes se ofertave, perndryshe oferta do te refuzohet.

Dokumentat si me siper duhet te jene te vlefshem pergjate gjithe periudhes se vlefshmerise se ofertes. Ne rastin kur sigurimi i ofertes ka formen e nje garancie bankare, Autoriteti Kontraktor ia rikthen ofertuesve sigurimin perkates brenda 15 diteve nga nenshkrimi i kontrates.

2.7 **Periudha e Vlefshmerise se Ofertes**

Periudha e vlefshmerise se ofertes fillon qe nga momenti i hapjes se ofertave. Ne çdo rast, *te pakten 5 dite nga perpara* perfundimit te afatit kohor per vlefshemrine e ofertave, autoriteti kontraktor mund t'i kerkoje Ofertuesit me shkrim te zgjase periudhen e vlefshmerise, deri ne nje date te caktuar. Ofertuesi mund t'a refuzoje kete kerkese me shkrim pa humbur te drejten per rimbursim te sigurimit te ofertes, kur ka nje tille. Ofertuesi qe bie dakord te zgjase periudhen e vlefshmerise se ofertes njofton Autoritetin Kontraktor me shkrim, dhe paraqet nje sigurim oferte te zgjatur, nese ka pasur nje te tille. Oferta nuk mund te modifikohet. Nese Ofertuesi nuk i pergjigjet kerkeses se bere nga Autoriteti Kontraktor lidhur me zgjatjen e periudhes se vlefshmerise se ofertes, ose nuk e pranon kerkesen ne fjale, ose nuk paraqet nje sigurim te zgjatur te ofertes, kur kerkohet, atehere Autoriteti Kontraktor do te refuzoje oferten.

**2.8** Veprimet e jashteligjshme sipas Nenit 26 te LPP-se

**Seksioni 3. <u>Vleresimi i ofertave</u>**

Public Health Sector

**3.1 Kriteret e perzgjedhjes**

**(Opsioni 1)** Çmimi me i ulet i ofertes se kualifikuar.

Kontrata do t'i akordohet atij Ofertuesi qe ka ofruar çmimin me ulet te ofertes.

**(Opsioni 2)** Oferta ekonomikisht me e favorshme.

Per kriteret vleresuese duhet percaktuar qarte pesha specifike e secilit kriter dmth sa pike do te kete çdo kriter dhe si do te llogariten piket per ofertuesit e njepasnjeshem.

Te gjitha kriteret e vendosura per vleresimin e ofertave duhet te jene sa me objektive dhe te shprehen ne shifra. Ne çdo rast, kur kriteret jane me shume se nje, pesha e kriterit te cmimit nuk do te jete me pak se 50 pike. Piket maksimale qe do te marre nje oferte do te jene 100.

Formula me te cilen do te llogariten piket e ofertuesve ne kete rast eshte:

$Po = Pk1+Pk2+Pk3+.....$

Ku:

Po - jane piket totale te ofertes se vleresuar
Pk1/Pk2/Pk3/... - jane piket per çdo kriter te vleresuar

Piket per çdo kriter perllogariten sipas formules:

$$Pk1 = Vmink1 \times Pmaxk1/Ok1$$

| | |
|---|---|
| Pk1 _____ | Piket e kriterit qe vleresohet |
| Vmin k1 | Vlera e me e ulet e kriterit qe vleresohet |
| Pmaxk1 | Piket maksimale qe i jepen kriterit qe vleresohet |
| Ok1 | Treguesi i ofertes per kriterin qe vleresohet |

**Sqarim**
Si kriter vleresimi duhet te perzgjidhet vetem njeri prej opsioneve. Plotesimi i te dy opsioneve e ben proceduren te pavlefshme.

Ne rastin e prokurimit te marreveshjes kuader, kur objekt i kesaj marreveshje jane biletat e transportit ajror nderkombetar, ne vend te çmimit do te perdoret marzhi i fitimit i shprehur ne perqindje.

### 3.2 Korrigjimi i gabimeve dhe pjeset e hequra

3.2.1 Autoriteti Kontraktor korrigjon ato gabime ne oferte, qe jane thjesht te nje natyre aritmetike, nese gabimi zbulohet gjate shqyrtimit te ofertave. Autoriteti Kontraktor e njofton menjehere Ofertuesin ne fjale me nje njoftim me shkrim/elektronik mbi çdo korrigjim te tille dhe mund te vazhdoje me ndryshimin e gabimit, me kusht qe Ofertuesi t'a kete miratuar kete komunikim qe i eshte bere. Nese Ofertuesi refuzon te pranoje korrigjimin e propozuar, atehere oferta do te refuzohet, pa konfiskim te sigurimit te ofertes, nese ekziston nje e tille.

3.2.2 Gabimet ne llogaritjen e çmimit do te korrigjohen nga Autoriteti Kontraktor, si me poshte:

- ne rast se ka mosperputhje ndermjet shumave te shprehura ne shifra dhe atyre ne fjale, atehere do te mbizoterojne shumat e shprehura ne fjale, me perjashtim te rasteve kur shuma ne fjale lidhet me nje gabim aritmetik;

- nese ka mosperputhje ndermjet çmimit njesi dhe vleres se pergjithshme qe merret nga shumezimi i çmimit njesi dhe sasise, atehere do te mbizoteroje çmimi njesi, dhe rrjedhimisht duhet te korrigjohet shuma ne total, nese ka nje gabim ne nje shume total, qe korrespondon me mbledhjen ose zbritjen e nentotaleve, atehere do te mbizoteroje nentotali dhe totali duhet te korrigjohet. Shumat e korrigjuara ne kete menyre jane te detyrueshme per ofertuesin. Nese ofertuesi nuk i pranon ato, atehere oferta e tij do te refuzohet *Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur shumat absolute te te gjitha korrigjimeve jane me shume se ± 2% e vleres se ofertes ekonomike te ofruar.*

Open Albania
Public Health Sector

## 3.3 Ofertat anomalisht te uleta

3.3.1 Nese oferta e dorezuar, rezulton anomalisht e ulet ne lidhje me sherbimet e ofruara, atehere Autoriteti Kontraktor i kerkon Ofertuesit ne fjale te justifikoje çmimin e ofruar. Nese Ofertuesi nuk arrin te jape nje justifikim qe te binde Autoritetin Kontraktor, atehere ky i fundit ka te drejte te refuzoje oferten.

3.3.2 Oferta do te cilesohet anomalisht e ulet sipas percaktimit te bere ne nenin 66 te Kreut VII te RrPP .

Ne rastin kur jane te vlefshme dy ose me pak oferta, ne perputhje me nenin 56, te LPP-se, oferta vleresohet anomalisht e ulet kur ajo eshte ulur me shume se 25 perqind e fondit limit te perllogaritur.

Ne rastin kur jane te vlefshme tre ose me shume oferta, ne perputhje me nenin 56 te LPP-se, oferta vleresohet anomalisht e ulet nese vlera e saj do te jete me e vogel se 85 perqind e mesatares se ofertave te vlefshme.

Nese nje apo disa oferta vleresohen si anomalisht te uleta, komisioni i vleresimit te ofertave duhet te kerkoje sqarime nga ofertuesit, perpara se te marre vendim per kualifikimin ose jo te tyre, ne perputhje me nenin 56 te LPP.

Ne çdo rast ofertuesi ka detyrimin te argumentoje dhe dokumentoje me prova shkresore sqarimet mbi elementin/elementet e veçante te ofertes, ne perputhje me kerkesat e nenit 56 te LPP.

Formula qe do te zbatohet per te cilesuar nje oferte anomalisht te ulet, ne rastin kur ka tre ose me shume oferta te vlefshme eshte si me poshte:

$O$ – Oferta
$M_O$ – Mesatarja e Ofertave te vlefshme
$n$ – Numri i Ofertave te vlefshme
$Z_M$ – Zbritja e Mundshme

**$M_O = O_1 + O_2 + O_3 + \dots O_n / n$**

**$Z_M = 85\ \%\ Mo$**

**Vlera e Ofertes qe vleresohet <ZM.......... , <u>si rrjedhim Oferta eshte Anomalisht e Ulet</u>**

Ne rastin kur kriter vleresimi eshte perzgjedhur oferta ekonomikisht me e favorshme, do te verifikohet nese ofertat jane anomalisht te uleta vetem nese oferta e klasifikuar me piket me te larta e ka oferten ekonomike me vleren me te ulet.

3.3.3 Ankimi administrativ ne dispozicion te Operatoreve Ekonomike sipas nenit 63 te LPP-se.

Open Procurement Albania
Public Health Sector

## Seksioni 4. <u>Nenshkrimi i kontrates</u>

### 4.1 Njoftimi i fituesit

Autoriteti Kontraktor njofton Ofertuesin fitues, permes dergimit te njoftimit te fituesit, siç parashikohet ne **Shtojcen 14.** Nje kopje e ketij njoftimi publikohet ne Buletinin e Njoftimeve Publike, siç kerkohet ne Nenin 58 te LPP-se.

### 4.2 Sigurimi i kontrates

4.2.1 Autoriteti Kontraktor kerkon sigurim per ekzekutimin e kontrates. Shuma e sigurimit per ekzekutimin e kontrates do te jete 10 % e vleres se kontrates. Formulari i Sigurimit te Kontrates, sipas **Shtojces 20 te DT**, duhet te nenshkruhet dhe te dorezohet para nenshkrimit te kontrates.

4.2.2 Sigurimi per ekzekutimin e kontrates mund te dorezohet ne nje nga format e meposhtme:

i. garanci bankare,
ii. garanci sigurimi,

Open Procurement Albania

**Ky formular nuk perdoret nga autoritetet kontraktore ne rastin e prokurimit te kontratave sektoriale.**

### 4.3 Njoftimi i kontrates se nenshkruar

Ne pajtim me RrPP, pas nenshkrimit te kontrates, autoriteti kontraktor dergon nje njoftim ne APP per publikim ne Buletinin e Njoftimeve Publike.

Public Health Sector

**Shenim**: Autoritetet kontraktore nuk duhet te nderhyjne per te bere asnje lloj ndryshimi ne dokumentat e tenderit nga pika 1 ne piken 4.

## III. SHTOJCAT

Shtojcat e meposhtme jane pjese perberese e DT:

Shtojca 1: Formulari i Ofertes Ekonomike
Shtojca 2: Formulari i Fteses per Oferte (ne rastin e Marreveshjes Kuader)
Shtojca 3: Formulari i Sigurimit te Ofertes
Shtojca 4: Formulari i Informacionit Konfidencial
Shtojca 5: Deklarate mbi permbushjen e Specifikimeve teknike dhe te Termave te References nga operatori ekonomik
Shtojca 6: Deklarate per konfliktin e interesit
Shtojca 7: Deklarate mbi permbushjen e kritereve te pergjithshme
Shtojca 8: Kriteret e pergjithshme te pranimit/kualifikimit
Shtojca 9: Specifikimet teknike
Shtojca 10: Planifikimi i kontratave ne marreveshjen kuader
Shtojca 11: Sherbimet dhe Grafiku i ekzekutimit
Shtojca 12: Termat e References
Shtojca 13. Formulari per Njoftimin e Skualifikimit
Shtojca 14: Formulari i Njoftimit te Fituesit
Shtojca 15: Formulari i Njoftimit te operatoreve ekonomike te suksesshem ne Marreveshjen Kuader
Shtojca 16: Kushtet e Pergjithshme te Kontrates
Shtojca 17: Kushtet e Veçanta te Kontrates
Shtojca 18: Formulari i Njoftimit te Kontrates se Nenshkruar
Shtojca 19: Formulari i Njoftimit te Kontrates se Nenshkruar per publikim ne Buletinin e Njoftimeve Publike
Shtojca 20: Formulari i Sigurimit te Kontrates
Shtojca 21: Formulari i Ankeses ne Autoritetin Kontraktor
Shtojca 22: Draft Marreveshja Kuader ku Jo te gjitha kushtet jane te percaktuara
Shtojca 23: Draft Marreveshja Kuader ku te gjitha kushtet jane te percaktuara
Shtojca 24: Formulari i Njoftimit te Anullimit

**Shtojca 1**

[ *Shtojce per t'u plotesuar nga operatori ekonomik*]

## FORMULARI I OFERTES EKONOMIKE

Emri i Ofertuesit_____________________

Per: *[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]*

* * *

Procedura e prokurimit: *[lloji i procedures]*

Pershkrim i shkurter i kontrates: *[objekti]*

Publikimi *(nese zbatohet):* Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]/ Nr.References ne faqen e APP-se*

* * *

Duke iu referuar procedures se lartpermendur, ne, te nenshkruarit, deklarojme se:

1. Çmimi total i ofertes sone eshte [*monedha dhe vlera e ofertes*]; pa TVSH;
2. Çmimi total i ofertes sone eshte [*monedha dhe vlera e ofertes*]; me TVSH

| **1** | **2** | **3** | **4** | **5** | **6** |
|---|---|---|---|---|---|
| **Nr** | **Pershkrimi i Sherbimeve** | **Sasia** | **Çmimi Njesi** | **Çmimi Total** | **Afati** |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| **Çmimi Neto )** | | | | | |
| **TVSH (%)** | | | | | |
| **Çmimi Total** | | | | | |

Nenshkrimi i ofertuesit ______________

Vula ______________

Shenim:
Çmimet duhet te shprehen ne Monedhen ____( e kerkuar ne dokumentat e tenderit)

**PER OPERATORET EKONOMIKE OFERTUES**

**Objekti : Model Preventivi per - "Sherbimi me roje private SH.P.S.F."**

**Vendrojet :**

1 . Dera kryesore 1 ( nje ) vendroje me 3 ( tre ) turne, TI+TII+TIII, 24 ore

2 . Dera Repartit Obstetrike 1 ( nje ) vendroje me 3 ( tre ) turne, TI+TII+TIII, 24 ore

3 . Dera Repartit Gjinekologji 1 ( nje ) vendroje me 2 ( dy ) turne, TI+TII, 16 ore

4 . Dera Administrates 1 ( nje ) vendroje me 1 ( nje ) turn, me orar 08.00 - 16.00, 8 ore, **per te cilen ( Ditet e Shtunde, Diele, Festa do te jene Pushim )**

Per Vendrojet 1+2+3, turnet jane si me poshte:

**Turni i I-re, orari 06.00 - 14.00; Turni i II-te, orari 14.00 - 22.00; Turni i III-te, orari 22.00 - 06.00**

**Vendroja 1 me 3 ( tre ) turne ( 4,98 punonjes/vendroje )**
**Vendroja 2 me 3 ( tre ) turne ( 4,98 punonjes/vendroje )**
**Vendroja 3 me 2 ( dy ) turne ( 3.32 punonjes/vendroje )**
**Vendroja 4 me 1 ( nje ) turn ( 1.08 punonjes/vendroje )**

| Nr | | | V/Roja 1 | V/Roja 2 | V/Roja 3 | V/Roja 4 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | a | Paga baze | | | | |
| | b | Shtesa Turni i II - te | | | | |
| | c | Shtesa Turni i III - te | | | | |
| **1** | | **Shuma 1 ( a+b+c )** | | | | |
| | d | Sigurime shoqerore, shendetsore | | | | |
| **2** | | **Shuma 2 ( 1+d )** | | | | |

**Shuma pa TVSH ( V/Roja 1 + V/Roja 2 + V/Roja 3 + V/Roja 4 )**
TVSH 20 %
**Shuma me TVSH**

**Shuma totale per 1 ( nje ) muaj, pa TVSH**

**Shtojca 2**

[*Shtojce per t'u plotesuar nga autoriteti kontraktor ne Marreveshjen Kuader gjate rihapjes se procesit te mini-konkursit*]

**FTESA PER OFERTE**

(*shkruani emrin e Autoritetit Kontraktor*)
fton per te paraqitur oferta ne proceduren per kryerjen e sherbimeve te meposhtme:
……………………………………………………………………………………………………
……………………………………………………………………………………………………
……………………………………………………………………………………………………
(*jepni nje pershkrim te sakte te objektit te kontrates dhe sasise siç perkufizohet ne Dokumentat e Tenderit (DT)*.

<u>Vendi i kryerjes se sherbimit</u>
*(jepni nje pershkrim te shkurter)*

Kohezgjatja e sherbimit ________________________

Oferta duhet te paraqitet
……………………………………………………………………………………………………
[*Jep adresen e sakte*]
Perpara
……………………………………………………………………………………………………
[*Percaktoni daten dhe oren perfundimtare*]

Kriteret e percaktimit te ofertes fituese

Forma e komunikimit:

Me shkrim __ Elektronik ( email, fax etj.) _____

Open Procurement Albania
Public Health Sector

**Shtojca 3**

[*Leter me logon e Bankes / Kompanise se Sigurimeve*]
[ *Shtojce per t'u paraqitur nga operatori ekonomik, kur kerkohet nga autoriteti kontraktor*]

**FORMULARI I SIGURIMIT TE OFERTES**

[Data _______]

Per: *[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]*
Ne emer te: *[Emri dhe adresa e ofertuesit te siguruar]*

Procedura e prokurimit *[lloji i procedures]*
Pershkrim i shkurter i kontrates: *[ objekti]*
Publikimi *(nese zbatohet):* Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]/ Nr.References ne faqen e APP-se*

Open Procurement Albania
Public Health Sector

Duke iu referuar procedures se lartpermendur,

Ne vertetojme se [*emri i ofertuesit te siguruar*] ka derdhur nje depozite prane [*emri dhe adresa e bankes / kompanise se sigurimit*] me nje vlere prej [*monedha dhe vlera, e shprehur ne fjale dhe shifra*] si kusht per sigurimin e ofertes, dorezuar nga operatori i lartpermendur ekonomik.

Marrim persiper te transferojme ne llogarine e [*emri i autoritetit kontraktor*] vleren e siguruar, brenda 15 (pesembedhjete) diteve nga kerkesa juaj e thjeshte dhe e pare me shkrim, pa kerkuar shpjegime, me kusht qe kjo kerkese te permende mospermbushjen e njerit nga kushtet e meposhtme:

- Ofertuesi e ka terhequr ose ka ndryshuar oferten, pas afatit perfundimtar per paraqitjen e ofertave ose para afatit perfundimtar, nese eshte percaktuar keshtu ne dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nenshkrimin e kontrates se prokurimit kur autoriteti kontraktor e kerkon nje gje te tille;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontrates, ku oferta eshte shpallur fituese ose nuk ka plotesuar ndonje kusht tjeter perpara nenshkrimit te kontrates se percaktuar ne dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim eshte i vlefshem per periudhen e specifikuar ne [*njoftimin e kontrates ose ftesen per tender*].

[Perfaqesuesi i bankes / kompanise se sigurimit]

**Shtojca 4**

[ *Shtojce per t'u plotesuar nga Operatori Ekonomik, nese eshte rasti*]

## LISTA E INFORMACIONIT KONFIDENCIAL

(Shenoni me poshte informacionin qe deshironi te mbahet konfidencial)

| Lloji, natyra e informacionit qe duhet te mbetet konfidencial | Numri i faqes dhe pikat e DT qe deshironi te mbeten konfidenciale | Arsyet pse ky informacion duhet te mbetet konfidencial | Afati kohor qe ky informacion te mbetet konfidencial |
|---|---|---|---|
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |

Open Procurement Albania
Public Health Sector

**KUJDES**

Çdo e dhene, qe nuk eshte regjstruar si e dhene konfidenciale, do te konsiderohet se titullari i ketyre te drejtave ka dhene vete pelqimin per dhenien e informacionit perkates dhe Autoriteti Kontraktor nuk mban asnje pergjegjesi per publikimin e ketij informacioni.

Nuk perben sekret tregtar informacioni, qe duhet te behet publik ne baze te ligjit, qe lidhet me shkeljen e ligjit, apo qe duhet te publikohet ne baze te praktikave te mira tregtare e parimeve te etikes tregtare. Perhapja e ketij informacioni vleresohet e ligjshme, nese nepermjet ketij akti synohet te mbrohet interesi publik.

**Shtojca 5**

[ *Shtojce per t'u plotesuar nga Operatori Ekonomik*]

**DEKLARATE MBI PERMBUSHJEN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**

Deklarate e operatorit ekonomik pjesemarres ne proceduren e prokurimit publik, qe do te zhvillohet ne date _________________ nga Autoriteti Kontraktor________________ me objekt ____________ me fond limit __________.

Une i nenshkruari _______________,me cilesine e ________ te personit juridik _______________deklaroj se:

Permbushim te gjitha specifikimet teknike, te percaktuara ne dokumentat e tenderit dhe e vertetojme kete me çertifikata e dokumenta (nese kerkohen nga autoriteti kontraktor), te dorezuar bashke me kete deklarate.

Data e dorezimit te deklarates ________________

Open Procurement Albania
Public Health Sector

Perfaqesuesi i ofertuesit

Nenshkrimi

V ula

**Shtojca 6**

[ *Shtojce per t'u plotesuar nga Operatori Ekonomik*]

**DEKLARATE**
**Mbi konfliktin e interesave**

Deklarate e operatorit ekonomik pjesemarres ne proceduren e prokurimit publik qe do te zhvillohet ne date _________________ nga Autoriteti Kontraktor________________ me objekt ____________ me fond limit __________.

Konflikti i interesit eshte gjendja e konfliktit ndermjet detyres publike dhe interesave private te nje zyrtari, ne te cilen ai ka interesa private, te drejperdrejte ose te terthorte qe ndikojne, mund te ndikojne ose duket sikur ndikojne ne kryerjen ne menyre te padrejte te detyrave dhe pergjegjesive te tij publike.

Ne zbatim te nenit 21 pika 1 e Ligjit Nr. 9367, date 07.04.2005, kategorite e zyrtareve percaktuar ne Kreun III, Seksioni II, qe iu ndalohet ne menyre absolute te perfitojne ne menyre te drejtperdrejte ose te terthorte nga lidhja e kontratave me nje pale nje institucion publik jane:

- Presidenti i Republikes, Kryeministri, zvkryeministri, ministrat, ose zvministrat,Deputetet, Gjyqtaret e Gjykates Kushtetuese, Gjyqtaret e Gjykates se Larte, Kryetari i Kontrollit te Larte te Shtetit, Prokurori i Pergjithshem, Gjyqtaret e Prokuroret ne nivelin e Gjykates se Shkalles se Pare e ne ate te Apelit, Avokati i Popullit, Anetari i Komisionit Qendror te Zgjedhjeve, Anetari i Keshillit te Larte te Drejtesise, Inspektori i Pergjithshem i Inspektoratit te Larte te Deklarimit dhe Kontrollit te Pasurive dhe Konfliktit te Interesave, Anetaret e Enteve Rregullatore, (Keshilli i Mbikqyrjes i Bankes se Shqiperise, perfshire Guvernatorin dhe Zv/Guvernatorin; te konkurrences, telekomunikacionit; energjise; furnizimit me uje; te sigurimeve; letrave me vlere; mediave), Sekretaret e Pergjithshem te institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar tjeter, ne çdo institucion publik, qe eshte te pakten i barazvlefshem per nga pozicioni me drejtoret e pergjithshem, titullaret e institucioneve te administrates publike qe nuk jane pjese e sherbimit civil.

  Per zyrtaret e nivelit te mesem drejtues sipas nenit 31, dhe per zyrtaret e parashikuar ne nenin 32 te kreut te III, seksioni 2 te ketj ligji, ndalimi sipas pikes 1 te ketij neni, per shkak te interesave private te zyrtarit, te percaktuara ne kete pike zbatohet vetem ne lidhjen e kontratave ne fushen e territorit dhe te juridiksionit te institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim zbatohet edhe kur pale eshte nje institucion i varesise.

Kur zyrtari eshte ne funksionin e kryetarit a te nenkryetarit te bashkise, komunes ose te keshillit te qarkut, te anetarit te keshillit perkates ose eshte zyrtar i nivelit te larte drejtues te nje njesie te

Open Procurement Public Health Sector

qeverisjes vendore, ndalimi per shkak te interesave private te zyrtarit, te percaktuara ne kete pike, zbatohet vetem ne lidhjen e kontratave, sipas rastit, me bashkine, komunen ose keshillin e qarkut, ku zyrtari ushtron keto funksione. Ky ndalim zbatohet edhe kur pale ne kontrate eshte nje institucion publik, ne varesi te kesaj njesie (neni 21 pika 2 e Ligjit Nr. 9367, date 07.04.2005).

Ndalimet e percaktuara ne nenin 21 pika 1, 2 te Ligjit Nr. 9367, date 07.04.2005, me perjashtimet perkatese, zbatohen ne te njejten mase edhe per personat e lidhur me zyrtarin qe ne kuptim te ketij ligji jane **bashkeshorti/ja, bashkejetuesi, femije ne moshe madhore, prinderit e zyrtarit te bashkeshortit/es dhe bashkejetuesit/es.**

Une i nenshkruari ____________________, me cilesine e perfaqesuesit te personit juridik ______________deklaroj nen pergjegjesine time personale se:

Jam ne dijeni te kerkesave dhe ndalimeve te percaktuara ne Ligjin Nr. 9367, date 07.04.2005 “Per parandalimin e konfliktit te interesave ne ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, si dhe ne aktet nenligjore te nxjerra ne zbatim te tij nga Inspektorati i Larte i Deklarimit dhe Kontrollit te Pasurive si dhe te Ligjit Nr. 9643, date 20.11.2006 “Per prokurimin publik”, i ndryshuar.

Ne perputhje me to deklaroj se asnje zyrtar i percaktuar ne **Kreun III, Seksioni II** te Ligjit Nr. 9367, date 7.4.2005, dhe ne kete deklarate, nuk zoteron interesa private ne menyre te drejtperdrejte ose te terthorte me personin juridik qe une perfaqesoj.

Data e dorezimit te deklarates _______________

**Emri, Mbiemri, Nenshkrimi**
___________________________

Open Albania
Public Health Sector

**Vula**

**Shtojca 7**

**[ *Shtojce per t'u plotesuar nga Operatori Ekonomik*]**

**DEKLARATE MBI PERMBUSHJEN E KRITEREVE TE PERGJITHSHME**

Deklarate e operatorit ekonomik pjesemarres ne proceduren e prokurimit qe do te zhvillohet ne date_______________ nga Autoriteti Kontraktor ___________ me objekt ___________________me fond limit __________.

Une i nenshkruari __________________me cilesine ___________te operatorit ekonomik ___________________ deklaroj nen pergjegjesine time te plote se:

- Operatori ekonomik ______________________ eshte i regjistruar ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe ka ne fushen e veprimtarise objektin e prokurimit. Ne rastin kur ofertuesi eshte nje organizate jofitimprurese, duhet te deklaroje se eshte i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, date 07.05.2001 "Per Organizatat jo Fitimprurese".
- Operatori ekonomik ____________________ nuk eshte denuar per shkelje penale, ne perputhje me Nenin 45/1 te LPP,
- Operatori ekonomik ____________________nuk eshte denuar me vendim te gjykates se formes se prere, per vepra qe lidhen me veprimtarine profesionale,
- Operatori ekonomik ____________________ nuk eshte ne proces falimentimi (statusi aktiv),
- Operatori ekonomik ____________________ ka paguar te gjitha detyrimet per pagimin e tatimeve e te kontributeve te sigurimeve shoqerore, sipas legjislacionit ne fuqi

Open Procurement Albania
Public Health Sector

**Ne çdo rast, autoriteti kontraktor ka te drejte te kryeje verifikimet e nevojshme mbi vertetesine e informacionit te deklaruar nga operatori ekonomik si me siper.**

**Data e dorezimit te deklarates _____________**

**Perfaqesuesi i ofertuesit**

**Nenshkrimi**

**Vula**

**Shtojca 8**

[ *Shtojce per t'u plotesuar nga Autoriteti Kontraktor*]

**1. KRITERET E PERGJITHSHME TE PRANIMIT/KUALIFIKIMIT**

Ofertuesi duhet te deklaroje se:

a) Eshte i regjistruar ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe ka ne fushen e veprimtarise objektin e prokurimit. Ne rastin kur ofertuesi eshte nje organizate jofitimprurese, duhet te deklaroje se eshte i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, date 07.05.2001 "Per Organizatat jo Fitimprurese".
b) nuk eshte ne proces falimentimi, (statusi aktiv)
b) nuk eshte denuar per shkelje penale, ne perputhje me Nenin 45/1 te LPP,
c) nuk eshte denuar me vendim te gjykates se formes se prere, per vepra qe lidhen me veprimtarine profesionale.
d) ka paguar te gjitha detyrimet per pagimin e tatimeve e te kontributeve te sigurimeve shoqerore, sipas legjislacionit ne fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet te deklaroje se i ploteson te gjitha kerkesat e renditura me siper nepermjet paraqitjes se nje vetedeklarate me shkrim.

Open Data Albania

Nese gjuha e perdorur ne procedure eshte gjuha shqipe, atehere dokumentat ne gjuhe te huaj duhet te shoqerohen me nje perkthim te noterizuar ne gjuhen shqipe.

Ne rastet e bashkimit te operatoreve ekonomike, çdo anetar i grupit duhet te dorezoje vetedeklaraten e lartpermendur.

Public Health Sector

**Kriteret e Pergjithshme per Pranim, nuk duhet te ndryshohen nga autoritetet kontraktore.**

**Keto kritere duhet te plotesohen me dorezimin e vetedeklarates me shkrim te subjektit, ne diten e hapjes se ofertes, sipas Shtojces 7.**

**Ne çdo rast, autoriteti kontraktor ka te drejte te kryeje verifikimet e nevojshme mbi vertetesine e informacionit te deklaruar nga operatori ekonomik si me siper.**

**Vec kesaj, nese oferta dorezohet nga nje bashkim operatoresh ekonomike, duhet te dorezohen:**

**a.** Marreveshja e noterizuar sipas se ciles bashkimi i operatoreve ekonomike eshte krijuar zyrtarisht;

**b.** Prokura e posaçme.

**2. KRITERET E VEÇANTA TE KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet te dorezoje:

a. Sigurimi i ofertes, (nese eshte i zbatueshem) sipas Shtojces 3;
b. Deklarate mbi permbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojces 5;
c. Deklarate mbi Konfliktin e Interesit, sipas Shtojces 6;
ç. Formulari i Ofertes, sipas Shtojces 1;
d. Vertetim qe konfirmon shlyerjen e te gjitha detyrimeve te maturuara te energjise elektrike te

kontratave te energjise qe ka operatori ekonomik qe eshte i regjistruar ne Shqiperi.

3. Kandidati/ofertuesi duhet te dorezoje:

*(te plotesohet nga autoriteti kontraktor),*

**3.1 Kapaciteti ligjor/profesional i operatoreve ekonomike:**

1. Licensë e shoqerisë për ushtrimin e aktivitetit të “Sherbimit te ruajtjes dhe/ose sigurisë fizike”, **nënkategoria 1.3.A,** “Sigurimi fizik i objekteve shtetërore e private si dhe veprimtarive social kulturore, sportive fetare e politike”, lëshuar nga QKL.
2. Çertifikatë e drejtuesit teknik të subjektit, e vlefshme për ushtrimin e veprimtarisë së ruajtjes dhe të sigurisë fizike për nënkategorinë 1.3.A.
3. Çertifikata për punonjës shërbimi në fushën e veprimtarisë së shërbimit për ruajtjen dhe sigurimin fizik të objekteve dhe pronave për të paktën 15 punonjës shërbimi, nga te cilet te pakten 3 (tre) punonjes do te jene te seksit femer, per sherbim ne Dera Repartit Obstetrike dhe Dera Repartit Gjinekologji per Turni i I-re, orari 06.00 - 14.00, të lëshuara nga Drejtoria e Policisë e Qarkut Tiranë;

**3.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**1.** Xhiroja mesatare vjetore gjatë tre viteve të fundit te ketë një vlere sa jo me vogel se vlera e fondit limit, te Marreveshjes Kuader. Për ketë operatori ekonomik duhet te paraqesë vërtetim nga Administrata Tatimore për xhiron e realizuar gjate tre viteve te fundit.

**3.3 Kapaciteti teknik:**

1. Dëshmi për shërbime të mëparshme të ngjashme në vleren 40 % te fondit limit qe konkurron te kryera gjate tre viteve te fundit nga data e zhvillimit te tenderit.

   Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohen vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

   Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat si dëshmi pranohen vetëm faturat tatimore te shitjes ku te shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
2. Akti i Miratimit të Qendrës së Kontrollit, miratuar nga Policia e Shtetit në Qarkun ku ushtron aktivitetin SHPSF si dhe Dokumenti i Performaces mbi mënyrën e ushtrimit të aktivitetit te operatorit ekonomik.

   Per kete duhet te paraqese **vertetim nga Drejtoria e Policise se Qarkut** ku jepet informacioni i mesiperm i kerkuar.

3. Vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve për numrin e punonjësve të siguruar për tre muajt e fundit (Janar, Shkurt, Mars) , shoqëruar me **listë pagesat e sigurimeve shoqërore** (formularët E-sig 025 a) për këtë periudhë të konfirmuara nga organet tatimore. Operatori ekonomik duhet të ketë minimalisht **15 punonjës** të siguruar në muaj, 1 (nje) drejtues teknik dhe administratorin.

4. Autorizim Individual në emër të shoqërisë për përdorimin e frekuencave per radiokomunikim dhe alarm të lëshuar nga AKEP në zbatim të ligjit Nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, me zonë mbulimi Tirane.

5. Ofertuesi duhet të disponojë se paku **1 (nje) automjet** për ndërhyrje në raste emergjente, në pronësi të shoqerisë apo të marre me qera. Per kete operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Leje e Qarkullimit dhe taksat e automjetit ne pronesi te shoqerise.

Ne rastin kur automjeti eshte marre me qera, Leja e Qarkullimit duhet te shoqerohet edhe me Kontraten noteriale te marrjes me qera, ku te jete percaktuar afati dhe qellimi i marrjes me qera.

Sqarim:

Operatorët ekonomikë duhet te paraqesin **analizen e kostos per oferten e paraqitur sipas, Shtojca 1 e DT-ve.**

Te gjithe dokumentat duhet te jene origjinale ose kopje te noterizuara te tyre. Rastet e mos-dorezimit te nje dokumenti, ose te dokumentave te rreme e te pasakta, konsiderohen si kushte per skualifikim.

**Shtojca 9**

[ *Shtojce per t'u plotesuar nga Autoriteti Kontraktor*]

## SPECIFIKIMET TEKNIKE

**KUJDES**

Specifikimet teknike nuk duhet te kene asnje kerkese apo reference te ndonje marke apo emer i

veçante, patente, vizatim ose tip, origjine specifike, prodhues ose sipermarres sherbimi, perveç rasteve kur nuk ekziston nje menyre e mjaftueshme, e sakte apo e kuptueshme, e pershkrimit te kerkesave, me kusht qe fjalet “ose ekuivalent” te perfshihen detyrimisht ne keto specifikime.

Skicimet, parametrat teknik etj:




Public Health Sector

Specifikimi i Materialeve:

Pershkrimi i kerkesave te zbatimit te sherbimeve ne lidhje me to:

**Vendrojet :**

1 . Dera kryesore 1 ( nje ) vendroje me 3 ( tre ) turne, TI+TII+TIII, 24 ore
2 . Dera Repartit Obstetrike 1 ( nje ) vendroje me 3 ( tre ) turne, TI+TII+TIII, 24 ore
3 . Dera Repartit Gjinekologji 1 ( nje ) vendroje me 2 ( dy ) turne, TI+TII, 16 ore

4 . Dera Administrates 1 ( nje ) vendroje me 1 ( nje ) turn, me orar 08.00 - 16.00, 8 ore,
**per te cilen ( Ditet e Shtunde, Diele, Festa do te jene Pushim )**
Per Vendrojet 1+2+3, turnet jane si me poshte:
**Turni i I-re, orari 06.00 - 14.00; Turni i II-te, orari 14.00 - 22.00; Turni i III-te, orari 22.00 - 06.00**

**Operatori ekonomik ne kryerjen e ketij sherbimi:**

* duhet te kete Personel ( Punonjes ) te liçensuar (**minimumi 15 punonjes** ), me lejet perkatese te leshuar nga Drejtoria e Policise se Qarkut ku prokurohet ne baze te ligjit 8770, date 19.04.2001 “Per SH.P.S.F”, te cilet duhet te jene te pajisur me uniforme te rregullt, ku te jete e reklamuar dhe stema e shoqerise, te kene radio komunikimi, si dhe mjete mbrojtese per realizimin e sherbimit.
* nga 15 punonjes**, nga te cilet te pakten 3 ( tre ) punonjes do te jene te seksit femer, per sherbim ne Dera Repartit Obstetrike dhe Dera Repartit Gjinekologji per Turni i I-re, orari 06.00 - 14.00.**
* te marre masa per parandalimin e vjedhjeve
* te marre masa per per ruajtjen e automjeteve dhe parkimin e drejte te tyre, te cilat ndodhen ne territorin e Institucionit.
* per vepra penale qe mund te ndodhin, te marre masa per ruajtjen e vendngjarjes, te siguroje provat e duhura, te beje ndalimin e autorit dhe te njoftoje organet perkatese.
* sherbimi te merret dhe te dorezohet me proces-verbal te rregullt, i cili do te kontrollohet edhe nga personat e autorizuar te Autoritetit Kontraktor.
* per çdo problem te vere ne dijeni personin pergjegjes te Autoritetit Kontraktor (te caktuar ne kontrate), te koordinoje punen dhe te marre masa per stabilizimin e gjendjes.
* te bashkerendoje punen me organet e rendit.
* te mos lejoje hyrjen ne objekt te asnje personi, kur ne te ka patur ngjarje qe kerkojne prova materiale, deri ne momentin e ardhjes se eksperteve perkates.

**Shtojca 10**

[ Shtojce per t’u plotesuar nga Autoriteti Kontraktor ne marreveshjen kuader]

**PLANIFIKIMI I**
**KONTRATAVE NE MARREVESHJEN KUADER**

| Sherbim:<br>Numri total i kontratave sipas Marreveshjes Kuader | | |
|---|---|---|
| **Kontrata Nr.** | **Titulli i Kontrates** | **Pershkrim i shkurter i kontrates** |
| **01** | | |
| **02** | | |
| **03** | | |
| **…** | | |

Open Procurement Albania
Public Health Sector

**Shtojca 11**

*( Shtojce per t'u plotesuar nga Autoriteti Kontraktor)*

*(Kjo Shtojce ne rastin e Marreveshjes Kuader do te plotesohet nga autoriteti kontraktor vetem gjate rihapjes se procesit te mini-konkursit)*

## SHERBIMET DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMIT

**Sherbimi qe kerkohet: Sherbimi me roje private SH.P.S.F. Marreveshje Kuader - me nje operator ekonomik ku te gjitha kushtet jane te percaktuara - me afat 12 muaj**

**Afatet e ekzekutimit: 12 muaj**

Open Procurement Albania
Public Health Sector

**Shtojca 12**

*( Shtojce per t'u ploteesuar nga Autoriteti Kontraktor)*

## TERMAT E REFERENCES

Objekti dhe qellimi i sherbimeve:

Detyrat:

Open Procurement Albania
Public Health Sector

Shperndarja:

**PER OPERATORET EKONOMIKE OFERTUES**

**Objekti : Model Preventivi per - "Sherbimi me roje private SH.P.S.F."**

**Vendrojet :**
1 . Dera kryesore 1 ( nje ) vendroje me 3 ( tre ) turne, TI+TII+TIII, 24 ore
2 . Dera Repartit Obstetrike 1 ( nje ) vendroje me 3 ( tre ) turne, TI+TII+TIII, 24 ore
3 . Dera Repartit Gjinekologji 1 ( nje ) vendroje me 2 ( dy ) turne, TI+TII, 16 ore
4 . Dera Administrates 1 ( nje ) vendroje me 1 ( nje ) turn, me orar 08.00 - 16.00, 8 ore, **per te cilen ( Ditet e Shtunde, Diele, Festa do te jene Pushim )**

Per Vendrojet 1+2+3, turnet jane si me poshte:
**Turni i I-re, orari 06.00 - 14.00; Turni i II-te, orari 14.00 - 22.00; Turni i III-te, orari 22.00 - 06.00**

**Vendroja 1 me 3 ( tre ) turne ( 4,98 punonjes/vendroje )**
**Vendroja 2 me 3 ( tre ) turne ( 4,98 punonjes/vendroje )**
**Vendroja 3 me 2 ( dy ) turne ( 3.32 punonjes/vendroje )**
**Vendroja 4 me 1 ( nje ) turn ( 1.08 punonjes/vendroje )**

| Nr | | | V/Roja 1 | V/Roja 2 | V/Roja 3 | V/Roja 4 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | a | Paga baze | | | | |
| | b | Shtesa Turni i II - te | | | | |
| | c | Shtesa Turni i III - te | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **1** | | **Shuma 1 ( a+b+c )** | | | | |
| | d | Sigurime shoqerore, shendetsore | | | | |
| **2** | | **Shuma 2 ( 1+d )** | | | | |

**Shuma pa TVSH ( V/Roja 1 + V/Roja 2 + V/Roja 3 + V/Roja 4 )**
TVSH 20 %
**Shuma me TVSH**

**Shuma totale per 1 ( nje ) muaj, pa TVSH**

Vendi i kryerjes se sherbimeve: **S.U.O.GJ “Mbreteresha Geraldine”**

Open Procurement Albania
Public Health Sector

**Shtojca 13**

[ *Shtojce per t'u plotesuar nga Autoriteti Kontraktor*]

## NJOFTIM STANDARD PER OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR[1]

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj per pjesemarrjen ne proceduren e lartpermendur te prokurimit publik. Procedura e kryer ne perputhje me Ligjin nr. 9643 date 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik" .

Open Procurement Albania

Oferta juaj u vleresua me kujdes sipas kushteve dhe kerkesave te percaktuara ne njoftimin e kontrates dhe ne dosjen e ofertes. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat, sepse oferta e dorezuar nga ju u refuzua per shkak te arsyes (-ve) se/te meposhtme :

______________________________________________________________________________
______________________________________________________________________________
______________________________________________________________________________
______________________________________________________________________________
______________________________________________________________________________
______________________________________________________________________________
______________________________________________________________________________

Public Health Sector

Nese mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjate procedures se prokurimit publik, atehere keni te drejte te filloni nje procedure rishikimi sic parashikohet ne Kreun VII te LPP.

Edhe pse nuk mundem te perdornim sherbimet tuaja ne kete rast, besoj se do te vazhdoni te jeni i interesuar ne nismat tona te prokurimit.

Me respekt
**< Emri >**

**Shtojca 14**

[ *Shtojce per t'u plotesuar Autoriteti Kontraktor*]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT**

[Data________]

Per: *[Emri dhe adresa e ofertuesit te shpallur fitues]*
Procedura e prokurimit:
Numri i references se procedures/lotit:
Pershkrim i shkurter i kontrates: *[Sasia ose qellimi dhe kohezgjatja e kontrates]*
Publikime te meparshme *(nese zbatohet):* Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]*
Kriteret e perzgjedhjes se fituesit: çmimi me i ulet   oferta ekonomikisht me e favorshme
Njoftojme se, kane qene pjesemarres ne procedure keta ofertues me vlerat perkatese te ofruara:

1.____________________________________ ________________________________
*Emri i plote i shoqerise* *numri i NIPT-it*
Vlera _________________________________
*(me numra dhe fjale)*

2.____________________________________ ________________________________
*Emri i plote i shoqerise* *numri i NIPT-it*
Vlera ______________________________
*(me numra dhe fjale)*
Etj.______________________________

Open Procurement Albania
Public Health Sector

Jane skualifikuar ofertuesit e meposhtem:
1.____________________________________ ________________________________
*Emri i plote i shoqerise* *numri i NIPT-it*
2.____________________________________ ________________________________
*Emri i plote i shoqerise* *numri i NIPT-it*

Perkatesisht per arsyet e meposhtme:
_____________________________________________________________________________
_____________________________________________________________________________
_____________________________________________________________________________

* * *

Duke iu referuar procedures se lartpermendur, informojme *[emri dhe adresa e ofertuesit te*

*shpallur fitues]* se oferta e paraqitur, me nje vlere te pergjithshme prej *[shuma perkatese e shprehur ne fjale dhe shifra]*/piket totale te marra *[_____]*eshte identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur te paraqisni prane *[emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit]* sigurimin e kontrates, siç parashikohet ne dokumentat e tenderit, brenda ____________ diteve nga dita e marrjes/publikimit te ketij njoftimi.

Ne rast se nuk pajtoheni me kete kerkese, ose terhiqeni nga nenshkrimi i kontrates, do te konfiskohet sigurimi i ofertes suaj (nese eshte kerkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues ne klasifikimin perfundimtar, oferta e te cilit eshte dorezuar me nje vlere te pergjithshme prej *[vlera perkatese e shprehur ne fjale dhe shifra]*, siç parashikohet ne nenin 58 te Ligjit nr.9643 date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit eshte bere ne date _____________________________

Ankesa: ka ose jo______________
(nese ka) ka marre pergjigje ne date ___________________________

Open Procurement Albania
Public Health Sector

**[Titullari i autoritetit kontraktor]**

**Shtojca 15**

[*Shtojce per t'u plotesuar nga Autoriteti Kontraktor ne rastin e marreveshjes kuader*]

## FORMULARI I NJOFTIMIT TE OPERATOREVE EKONOMIKE TE SUKSESSHEM NE MARREVESHJEN KUADER

*[Data]*

Per: *[Emri dhe adresa e operatoreve ekonomike te shpallur fitues]*

1.________________________________________

*2.* ________________________________________

*3.*________________________________________

* * *

Procedura e prokurimit:

Numri i references se procedures/lotit:

Pershkrim i shkurter i kontrates: *[Sasia, objekti , kohezgjatja e kontrates etj]*

Publikime te meparshme *(nese zbatohet):* Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]*

Kriteret e perzgjedhjes se fituesit: çmimi me i ulet oferta ekonomikisht me e favorshme

Public Health Sector

Njoftojme se, kane qene pjesemarres ne procedure keta operatore ekonomike me vlerat perkatese te ofruara:

1.________________________________ ______________________________

*Emri i plote i shoqerise* *numri i NIPT-it*

Vlera ______________________________

*(me numra dhe fjale)*

2.________________________________ ______________________________

*Emri i plote i shoqerise* *numri i NIPT-it*

Vlera _____________________________

*(me numra dhe fjale)*

Etj._____________________________

Jane skualifikuar operatoret ekonomike te meposhem:

1.________________________________ ______________________________

*Emri i plote i shoqerise* *numri i NIPT-it*

2.___________________________________ _______________________________

*Emri i plote i shoqerise* __________________*numri i NIPT-it*

Perkatesisht per arsyet e meposhtme:

_____________________________________________________________________________________
_____________________________________________________________________________________
_____________________________________________________________________________________

* * *

Duke iu referuar procedures se lartpermendur, informojme se jane identifikuar si operatore ekonomike te suksesshem:

1.___________________________________ _______________________________

*Emri i plote i shoqerise* *numri i NIPT-it*

Vlera _______________________________/ Piket totale te marra ________________

*(me numra dhe fjale)*

2.__________________________________ _______________________________

*Emri i plote i shoqerise* *numri i NIPT-it*

Vlera ______________________________/ Piket totale te marra _________________

*(me numra dhe fjale)*

Etj.________________________________

Open Procurement Albania
Public Health Sector

Rrjedhimisht, jeni i lutur te paraqiteni prane *[emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit]*, brenda _____________ diteve nga dita e marrjes/publikimit te ketij njoftimi per te lidhur draft marreveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit eshte bere ne date _______________________________

Ankesa: ka ose jo_______________

(nese ka) ka marre pergjigje ne date _____________________________

**[Titullari i autoritetit kontraktor]**

**Shtojca 16**

## KUSHTET E PERGJITHSHME TE KONTRATES
## Sherbimet – Procedura e Hapur

### Neni 1 Qellimi

1.1 Keto kushte te pergjithshme te kontrates (KPK) do te zbatohen per kryerjen e Sherbimeve te prokuruara me ane te procedures se hapur.

1.2 Ligji per Prokurimin Publik ne Republiken e Shqiperise parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do te zbatohen per kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita te Kodit Civil jane rishprehur ne KPK me qellim qe te rrisin transparencen e kushteve te kontrates. Megjithate, citimi i disa dispozitave ketu nuk mohon ne asnje menyre zbatimin e dispozitave te tjera te Kodit Civil te kesaj kontrate.

1.3 Ne menyre te ngjashme, disa dispozita te Ligjit mbi Prokurimin Publik jane rishprehur ne KPK me qellim qe te rrisin transparencen e ligjit qe rregullon prokurimin publik. Megjithate, citimi i disa dispozitave ketu nuk mohon ne asnje menyre zbatimin e dispozitave te tjera te Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi te drejtat, detyrat dhe detyrimet e paleve.

1.4 KPK do te zbatohen deri ne ate mase qe te mos lene menjane kushtet ose dispozitat e paraqitura ne pjese te tjera te kontrates.

Kushtet e kontrates, perfshijne gjithashtu Kushtet e Veçanta te Kontrates (KVK). Ne rast se ka nje konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do te mbizoterojne mbi KPK.

### Neni 2 Perkufizime

2.1 "Kontrate" do te thote marrveshja e shkruar e lidhur midis Bleresit Publik dhe Kontraktuesit qe perbehet nga dokumentat e tenderit duke perfshire KPK dhe KVK, te gjitha bashkangjitjet dhe formularet e plotesuar dhe te gjitha dokumentat e tjera qe perfshihen ne referimin e çdo dokumenti.

2.2 "Cmim kontrate" do te thote çmimi qe i paguhet Kontraktuesit sipas kontrates per zbatimin e plote dhe te perpikte te detyrimeve te tij kontaktore.

2.3 "Objekt i kontrates" do te thote te gjitha Sherbimet qe Kontraktuesi do te siguroje sipas kushteve te kontrates.

2.4 "Pale (t)" do te thote nenshkruesit e kontrates.

2.5 "Autoriteti Kontraktor" do te thote Autoriteti Kontraktor qe eshte pjese e kesaj kontrate dhe sipas dispozitave te kesaj kontrate blen sherbimin. Ky term kudo qe perdoret ka kuptim te njejte me ate te perkufizuar ne ligj.

2.6 "Kontraktues" do te thote personi fizik ose juridik qe eshte pale e kesaj kontrate dhe sipas dispozitave te kesaj kontrate shet Sherbimet.

Open Procurement Albania
Public Health Sector

2.7 “Sherbime” do te thote te gjitha detyrat qe do te kryhen nga Kontraktuesi sipas kontrates.

2.8 “Termat e References” shprehin objektin dhe qellimin e kontrates, percaktojne detyrat, kerkesat, objektivat, shperndarjen, vendin dhe dorezimin e Sherbimeve qe do te sigurohen.

**Neni 3 Hartimi i Kontrates**

3.1 Shpallja e fituesit do te sherbeje per hartimin e kontrates midis paleve, e cila duhet te firmoset brenda afatit te shprehur ne dokumentat e tenderit.

3.2 Ekzistenca e kontrates do te konfirmohet me nenshkrimin e dokumentit te kontrates duke materializuar te gjitha marreveshjet midis paleve.

**Neni 4 Praktikat Korruptive, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve**

4.1 Autortiteti Kontraktues mund t’i kerkoje Gjykates te deklaroje te paligjshme kontraten ne se zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive perfshijne veprimet e pershkruara ne Nenin 26 te Ligjit per Prokurimin Publik.

4.2 Kontraktuesi nuk duhet te kete lidhje (te tashme ose te shkuara) me asnje konsulent ose njesi qe ka marre pjese ne pregatitjen e dokumentave te tenderit per kete prokurim.

4.3 Kontraktuesi duhet te lejoje Autoritetin Kontraktues te inspektoje llogarite dhe procesverbalet qe kane lidhje me zbatimin e kontrates ose t’i kontrolloje ato me ane te kontrolloreve te emeruar nga Autoriteti Kontraktues.

Open Procurement Albania
Public Health Sector

**Neni 5 Informacioni Konfidencial**

5.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet te mbajne ne konfidence te gjitha dokumentat, te dhenat dhe informacionet e tjera te dhena nga pala tjeter ne lidhje me kontraten.

5.2 Kontraktuesi mund t’i jape nenkontraktuesit dokumenta te tilla, te dhena ose informacione te tjera qe merr nga Autoriteti Kontraktues deri ne masen e kerkuar per nen-kontraktuesin ne menyre qe ai te kryeje punen e tij sipas kontrates. Ne rast te tille, Kontraktuesi duhet te perfshije ne kontraten e tij me nenkontraktuesin nje dispozite qe premton ruajtjen e konfidences siç thuhet ne Paragrafin 5.1 me siper.

**Neni 6 Prona Intelektuale**

6.1 Me perjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe ne kontrate, te gjitha te drejtat e prones intelektuale te siguruara nga Kontraktuesi gjate Kontrates do t’i perkasin Autoritetit Kontraktues i cili mund t’i perdore ato sipas gjykimit te tij.

6.2 Me perjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe ne kontrate, Furnizuesi, pas perfundimit te kontrates, duhet t’i dorezoje Autoriteti Kontraktues te gjitha raportet dhe te dhenat si hartat, diagramet, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbeshtetes ose materialet e fituara, mbledhura ose pregatitura nga Kontraktuesi gjate

kontrates. Kontraktuesi mund te mbaje kopje te ketyre dokumentave dhe te dhenave, por nuk duhet t'i perdori per qellime qe s'kane lidhje me kontraten pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktues.

6.3 Kontraktuesi duhet te siguroje Autoritetin Kontraktues nga mospergjegjesia per shkelje te te drejtave te prones intelektuale qe mund te dalin nga prodhimi ose kryerja e Sherbimeve sipas kontrates.

6.4 Ne rast se ngrihet ndonje pretendim ose padi kunder Autoriteti Kontraktues ne lidhje me ndonje shkelje te prones intelektuale te shkaktuar nga zbatimi i kontrates ose nga perdorimi i gjerave te furnizuara sipas kontrates, Kontraktuesi duhet t'i jape Autoriteti Kontraktues te gjitha provat dhe informacionin ne posedim te Kontraktuesit qe kane te bejne me kete padi apo pretendim.

**Neni 7 Detyrimet e Pergjithshme te Kontraktuesit**

7.1 Kontraktuesi duhet t'i kryeje Sherbimet dhe permbushi detyrimet e tij me te gjitha perpjekjet, eficiente dhe ekonomike ne pajtim me teknikat dhe praktikat profesionale te pranuara ne pergjithsi.

7.2 Kontraktuesi duhet te ndjeke praktika te shendosha te biznesit dhe te perdore teknologji te avancuar dhe te pershtatshme si dhe metoda te sigurta.

7.3 Ne se kontrata kerkon kryerjen e sherbimeve keshillimore profesionale, Kontraktuesi duhet te veproje gjithmone si nje keshillues besnik i Autoriteti Kontraktues, ne pajtim me rregullat dhe kodin e sjelljes te profesionit te tij dhe duhet qe te mbeshtesi dhe ruaje gjithmone interesin publik.

7.4 Ne se kontrata kerkon kryerjen e sherbimeve keshillimore profesionale, Kontraktuesi duhet te ushtroje kujdes te plote ne mardheniet me palet e treta duke perfshire median dhe nuk duhet te marre pjese ne veprime qe jane jashte kompetences se tij ne perfaqsimin e Autoritetit Kontraktues.

**Neni 8 Detyrimet e Veçanta te Kontraktuesit**

8.1 Kontraktuesi duhet te kryeje te gjitha Sherbimet siç specifikohet tek Termat e References.

8.2 Kontraktuesi duhet t'i paraqese Autoritetit Kontraktues te gjitha sherbimet, ne sasite e percaktuara, siç kerkohen nga kontrata duke perfshire, por jo te kufizuara nga, te gjitha raportet, dokumentat, studimet, skicimet dhe planimetrite.

8.3 Kontraktuesi duhet te siguroje raportet e lidhura me zbatimin e Sherbimeve siç kerkohet ne kontrate.

**Neni 9 Specifikime dhe Skicime**

9.1 Ne se kontrata kerkon sherbime skicimi, Kontraktuesi duhet te pregatisi te gjitha specifikimet dhe skicimet duke perdorur sisteme te pranuara dhe te njohura ne pergjithsi te

pranueshme per Autoritetet Kontraktues dhe te marri parasysh standartet me te fundit.

9.2 Nese kontrata kerkon sherbime skicimi, Kontraktuesi duhet te siguroje se te gjitha specifikimet, skicimet dhe kerkesat e tjera jane pregatitur ne baze asnjanese persa i perket nxitjes se konkurences ne prokurimin e objekteve te skicimit.

**Neni 10 Lejet dhe Liçensat**

10.1 Kontraktuesi do te jete pergjegjes per sigurimin e lejeve ose liçensave sipas kerkesave te Ligjeve te Republikes se Shqiperise per kryerjen e Sherbimeve ne kete kontrate vec rastit kur palet bien dakord ndryshe.

**Neni 11 Heqja dhe Zevendesimi i Personelit Kryesor**

11.1 Kontraktuesi duhet te siguroje aprovim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues perpara heqjes ose zevendesimit te personelit kryesor siç pershkruhet ne oferten e Kontraktuesit.

11.2 Kontraktuesi do te zevendesoje çdo punonjes ne se Autoriteti Kontraktues zbulon se personi ka kryer veprime te jashteligjshme ose Autoriteti Kontraktues eshte mjaft i pakenaqur nga puna e personit.

11.3 Nese behet e nevojshme te zevendesohet ndonje nga personeli kryesor, Kontraktuesi duhet te siguroje si zevendesues nje person me kualifikime ekuivalente ose me te mira.

11.4 Kontraktuesi do te paguaje kosto shtese per zevendesimin e personelit kryesor me perjashtim kur shkaku i zevendesimit ka ardhur nga neglizhenca ose mungesa e kujdesit te Autoriteti Kontraktues.

Open Procurement Albania
Public Health Sector

**Neni 12 Vendndodhja**

12.1 Sherbimet duhet te kryhen ne vendin ose vendet e specifikuara ne kontrate.

12.2 Ne se nuk eshte specifikuar vendi, Autoriteti Kontraktues rezervon te drejten te aprovoje vendin ose vendet e kryerjes se Sherbimeve, megjithate, aprovimi nuk duhet te vonohet ne menyre te paarsyeshme.

**Neni 13 Siguracioni i Pergjegjesise Profesionale**

13.1 Kontraktuesi duhet te mbaje siguracion per pergjegjesi profesionale sipas rregullave dhe praktikave te njohura ne pergjithsi per profesionin per ta zhdemtuar Autoriteti Kontraktues per deme te rezultuara nga neglizhenca, gabimet ose mangesite, ne kryerjen e Sherbimeve.

13.2 Nese nuk eshte percaktuar ne kontrate shuma minimale e siguracionit, Kontraktuesi duhet te siguroje siguracion ne shumen e njohur ne pergjithsi si te mjaftueshme nen rrethanat e Sherbimeve qe po sigurohen.

**Neni 14 Çmimi i Kontrates**

14.1 Çmimi i kontrates duhet te jete çmimi i ofruar ne oferten e Kontraktuesit dhe i pranuar nga Autoriteti Kontraktues.

**Neni 15 Afatet e Pageses**

15.1 Çmimi i kontrates, duke perfshire çdo pagese paraprake, duhet te paguhen ne kohe siç specifikohet ne kontrate.

15.2 Me perjashtim kur parashikohet nga nje dispozite tjeter ne kontrate, pagesa duhet bere ne monedhe Shqiptare. Kursi i shkembimit i monedhave te ndryshme do te jete kursi i Bankes se Shqiperise ne diten kur eshte derguar njoftimi i kontrates per botim.

15.3 Me perjashtim kur parashikohet nga nje dispozite tjeter ne kontrate, kerkesa e Kontraktuesit per pagese duhet t'i behet Autoriteti Kontraktues me shkrim. Per çdo kerkese, Kontraktuesi duhet te paraqese origjinalin dhe kopjen se bashku me nje liste te sendeve qe pershkruan sherbimet e kryera per te cilat duhet paguar.

15.4 Me perjashtim kur parashikohet nga nje dispozite tjeter ne kontrate, pagesa per sherbimet do te behet brenda 30 diteve kalendarike nga dita qe jane kryer Sherbimet, dorezimi eshte paraqitur ose arritur, ose nga dita e marrjes se kerkeses per pagese cilado te jete me e vone.

15.5 Data e pageses do te jete dita qe fondet debitohen nga llogaria e Autoritetit Kontraktues.

**Neni 16 Vonesa ne Berjen e Pageses**

Ne rast te verifikimit te vonesave ne kryerjen e pagesave nga ana e Autoritetit Kontraktor, megjithese kontraktuesi ka permbushur te gjitha detyrimet e tij ne perputhje me kushtet e kontrates, detyrimet e prapambetura dhe kamatevonesat perkatese do te kryhen ne perputhje me parashikimet e ligjit nr. 48/2014 "Per pagesat e vonuara ne detyrimet kontraktore e tregtare".

**Neni 17 Ndryshimi i Ligjeve dhe Rregulloreve**

17.1 Nese pas dates se dorezimit te ofertave ose dates se nenshkrimit te kontrates, ndonje ligj ose akt nenligjor ne Republiken e Shqiperise hyn ne fuqi ose ndryshon dhe ndikon kushtet, duke perfshire daten e dorezimit ose çmimin e kontrates, kushtet ose çmimi i kontrates do te rregullohen ne ate mase sa kontraktuesi eshte ndikuar ne permbushjen e detyrimeve te tij sipas kontrates..

**Neni 18 Forca Madhore**

18.1 Kontraktuesi nuk duhet te mbaje pergjegjesi per humbjen e depozites se kontrates, demet e likuiduara ose nderprerjen per mosplotesim nese dhe deri ne masen qe vonesa ne zbatim ose ndonje deshtim tjeter ne zbatimin e detyrimeve te tij sipas kontrates vijne si rezultat i ndodhjes se Forces Madhore.

18.2 Per qellimet e ketij neni "Force Madhore" do te thote nje ngjarje e paparashikueshme jashte kontrollit te Kontraktuesit mbi fajin ose neglizhimin. Ngjarje te tilla mund te

perfshijne, por nuk jane te limituara nga, veprimet e Autoritetit Kontraktues qofte ne kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, lufta ose revolucionet, zjarri, permbytja, termeti, epidemite, shtrengime te karantines dhe embargo tranziti.

18.3 Ne se ndodh ndonje situate e Forces Madhore, Kontraktuesi duhet te njoftoje menjehere Autoriteti Kontraktues. Me perjashtim kur Autoriteti Kontraktues jep direktiva te ndryshme, Kontraktuesi duhet te vazhdoje te zbatoje detyrimet e tij sipas kontrates ne masen praktikisht te arsyeshme dhe duhet te kerkoje te gjitha mjetet e arsyeshme per zbatimin qe nuk pengohet nga Forca Madhore.

**Neni 19 Vonesa ne Zbatim dhe Zgjatja e Afatit**

19.1 Me perjashtim kur parashikohet ndryshe, Kontraktuesi duhet te filloje zbatimin e kontrates menjehere pas nenshkrimit te saj.

19.2 Me perjashtim te rastit kur Autoriteti Kontraktues eshte dakord per zgjatje te afatit te kontrates, Autoriteti Kontraktues ka te drejte te likuidoje demet per vonesen ne zbatim nese Kontraktuesi deshton ne kryerjen e Sherbimeve brenda periudhes se Kontrates.

19.3 Autoriteti Kontraktues mund te zbrese shumen e demeve te likuiduara qe duhet paguar nga shuma e pageses ndaj Kontraktuesit. Ne rast te tille Autoriteti Kontraktues duhet t'i japi kontraktuesit njoftim me shkrim per shumen dhe arsyen e zbritjes.

19.4 Autoriteti Kontraktues do te jete dakort per nje zgjatje te afatit ne rastin e Forces Madhore.

19.5 Autoriteti Kontraktues mund te jete dakort per zgjatje te afatit edhe ne rrethana te tjera nese eshte ne interesin publik per ta bere kete. Ne rast se Kontraktuesi ndeshet me kushte qe pengojne zbatimin ne kohe, Kontraktuesi duhet te njoftoje menjehere Autoritetin Kontraktor me shkrim per vonesen, shkakun dhe daten e propozuar te perfundimit te Sherbimeve. Autoriteti Kontraktor duhet te vleresoje kerkesen. Nese Autoriteti Kontraktor eshte dakort me vonesen, zgjatja do te hyje ne fuqi me nje amendament me shkrim te kontrates te nenshkruar nga Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktuesi.

**Neni 20 Likuidimi i Demeve per Dorezimin e Vonuar**

20.1 Demet e likuidueshme per kryerjen e vonuar te Sherbimeve do te llogariten me tarifat e meposhtme ditore:

a) Per kontratat me periudhe zbatimi jo me shume se 6 muaj, tarifa ditore do te jete 4/1000 te vleres koresponduese te mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontrates por kjo vlere do te llogaritet minimalisht mbi 25% te vleres se kontrates.

b) Per kontratat me periudhe zbatimi jo me shume se 12 muaj, tarifa ditore do te jete 2/1000 te vleres koresponduese te mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontrates por kjo vlere do te llogaritet minimalisht mbi 25% te vleres se kontrates..

c) Per kontratat me periudhe zbatimi me shume se 12 muaj, tarifa ditore do te jete 1/1000 te vleres koresponduese te mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontrates por kjo vlere do te llogaritet minimalisht mbi 25% te vleres se kontrates...

**Neni 21 Negociatat dhe Amendamentet**

21.1 Palet nuk do te negociojne ndryshime ose amendamente te asnje elementi te kontrates qe do te ndryshonte mjaftueshem kushtet qe perbejne bazen e perzgjedhjes se Kontraktuesit.

21.2 Asnje amendament ose variacion tjeter i kontrates nuk do te jete i vlefshem pa qene me shkrim, me date, t'i referohet shprehimisht kontrates dhe nenshkruhet nga nje perfaqsues i autorizuar i Kontraktuesit dhe Autoritetit Kontraktor.

21.3 Çdo heqje dore nga te drejtat, pushtetet ose ndreqjet qe mund te behen nga palet sipas kontrates duhet te behet me shkrim, te kete date dhe te firmoset nga nje perfaqsues i autorizuar i pales qe ben kete doreheqje dhe duhet te specifikoje te drejten dhe masen ne te cilen ajo leshohet.

**Neni 22 Ndryshimi i Porosise**

22.1 Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten te porosise Sherbime shtese deri ne nje sasi qe nuk i kalon 20% te çmimit total te kontrates. Çdo porosi shtese duhet te behet ne menyre konsistente me rregullat dhe procedurat e parashikuara ne Ligjin mbi Prokurimin Publik.

**Neni 23 Nderprerja per Mosplotesim**

Open Procurement Albania

23.1 Autoriteti Kontraktor mund te nderprese kontraten ne teresi ose pjeserisht nese:
- a) Kontraktuesi deshton te kryeje Sherbimet brenda periudhes se specifikuar ne kontrate ose brenda zgjatjes se dhene; ose,
- b) Kontraktuesi deshton te zbatoje ndonje detyrim tjeter te kontrates.

Public Health Sector

23.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit njoftim me shkrim per nderprerjen per mosplotesim dhe t'i japi Kontraktuesit 15 dite te ndreqe mosplotesimin me perjashtim kur nderprerja eshte bere per veprime korruptive ose te paligjshme, rast ne te cilin nderprerja do te jete e menjehershme.

**Neni 24 Nderprerja per Shkak te Falimentimit**

24.1 Autoriteti Kontraktor mund te nderprese kontraten ne çdo kohe nese Kontraktuesi falimenton ose behet i paafte te paguaje.

24.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit njoftim me shkrim per nderprerjen.

**Neni 25 Nderprerja per Shkak te Interesit Publik**

25.1 Autoriteti Kontraktor mund te nderprese kontraten ne çdo kohe nese gjykon se ky veprim duhet ndermarre per t'i sherbyer sa me mire interesit publik.

25.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit lajmerim me shkrim per nderprerjen.

25.3 Autoriteti Kontraktor duhet te paguaje Kontraktuesin per te gjitha Sherbimet e kryera perpara nderprerjes dhe duhet t'i paguaje Kontraktuesit demet e shkaktuara per kryerjen e

pjesshme te Sherbimeve. Ne llogaritjen e shumes se demeve, Kontraktuesi do te kerkohet te ndermarre te gjitha veprimet e nevojshme per te minimizuar demet.

**Neni 26 Nenkontrata**

26.1 Nje nenkontrate do te jete e vlefshme vetem nese eshte ne formen e nje marreveshjeje te shkruar me ane te se ciles kontraktori i beson kryerjen e nje pjese te detyrimeve te kontrates se tij nje pale te trete

26.2 Kontraktori nuk duhet te nenkontraktoje pa aprovimin paraprak me shkrim te Autoritetit Kontraktor dhe jo me shume se 40% te vleres se kontrates. Kontraktori duhet te njoftoje Autoritetin Kontraktor per elementet e kontrates qe nenkontraktohet dhe dokumentacionin qe provon aftesine e nenkontraktorit. Autoriteti Kontraktor duhet te lajmeroje kontraktorin per vendimin e tij, brenda 5 diteve nga marrja e njoftimit, duke shprehur arsyet nese e aprovon apo jo ate.

26.3 Cdo nenkontraktor duhet te kete te drejte te marre pjese ne prokurimin publik sipas Ligjit mbi Prokurimin Publik. Autoriteti mund te parashikoje pagesa direkte tek nenkontraktori per sherbimet qe do te furnizoje.

26.4 Kur Kontraktuesi ka nder mend te realizoje nje pjese te punimeve me nen-kontraktues, duhet te paraqese ne oferte, sipas dokumentave te tenderit, gjithe dokumentacionin e kerkuar per nenkontraktuesin si dhe punimet konkrete qe do te jape me nensipermarrje.

26.5 Kontraktori mbetet plotesisht pergjegjes per zbatimin e kontrates pamvaresisht nga sjellja e nenkontraktorit.

**Neni 27 Transferimi i te Drejtave**

Public Health Sector

31.1 Kontraktuesi nuk duhet te transferoje, teresisht ose pjeserisht, detyrimet e tij sipas kontrates me perjashtim kur jepet miratimi paraprak i Autoritetit Kontraktor.

**Neni 28 Sigurimi i Kontrates**

28.1 Perpara nenshkrimit te kontrates, kontraktuesi duhet t'i dorezoje Autoritetit Kontraktor sigurimin e kontrates ne shumen dhe formen e kerkuar.

28.2 Shuma e sigurimit te kontrates duhet t'i paguhet Autoritetit Kontraktor si kompensim per çdo humbje te rezultuar nga deshtimi i Kontraktuesit ne plotesimin e detyrimeve te tij sipas kontrates.

28.3 Sigurimi i kontrates do t'i kthehet Kontraktuesit jo me vone se 30 dite pas dates se kryerjes se Sherbimeve.

**Neni 29 Baza Ligjore**

29.1 Kontrata do te rregullohet nga dispozitat e legjislacionit shqiptar ne fuqi.

**Neni 30 Zgjidhja e Mosmarrveshjeve**

30.1 Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktuesi duhet te bejne çdo perpjekje te zgjidhin mosmarrveshjet ose konfliktet e ndodhura midis tyre ose ne lidhje me kete marrveshje me negociata direkte.

30.2 Nese palet deshtojne ne zgjidhjen e mosmarrveshjes ose konfliktit, problemet do te konsiderohen me ane te zgjidhjes se marrveshjeve sipas kontrates dhe procedurave juridike ne fuqi sipas legjislacionit te Republikes se Shqiperise.

**Neni 31 Perfaqesimi i Paleve**

31.1 Çdo pale duhet te emeroje me shkrim nje person ose post organizativ, qe do te jete pergjegjes, ne emer te pales, per marrjen e komunikatave dhe per perfaqesimin e pales ne çeshtjet e lidhura me egzekutimin e kontrates.

31.2 Secila pale duhet te lajmeroje palen tjeter menjehere per ndonje ndryshim ne emerimin e perfaqsuesit te pales. Nese njera pale deshton te lajmeroje, duhet te marri persiper çdo humbje te shkaktuar nga deshtimi per te dhene njoftim te mjaftueshem.

31.3 Palet mund te emerojne persona ose njesi organizative shtese per te perfaqsuar palen ne veprime ose veprimtari te veçanta njoftimi me shkrim ne te cilin rast duhet dhene dhe duhet te percaktoje shtrirjen e autoritetit te perfaqsuesit.

**Neni 32 Lajmerimet**

32.1 Çdo lajmerim i dhene nga njera pale tjetres sipas kontrates duhet te behet me shkrim ne adresen e specifikuar ne kontrate.

32.2 Njoftimi do te kete efekt sapo te dorezohet.

**Neni 33 Llogaritja e Afateve**

33.1 Te gjitha referencat e diteve do te jene dite kalendarike me perjashtim kur parashikohet ndryshe.

Open Procurement Albania
Public Health Sector

**Shtojca 17**

[ *Shtojce per t'u plotesuar nga Autoriteti Kontraktor*]

# KUSHTET E VEÇANTA
## Sherbimet – Procedura e Hapur

Kushtet e veçanta te Kontrates hartohen ne perputhje me objektin konkret te kontrates. Ne rast se ka mosperputhje midis KPK dhe KVK do te mbizoterojne Kushtet e veçanta te kontrates.

**Neni 1 Perkufizime**

1.1 Autoriteti Kontraktor eshte ________________________________________________

1.2 Kontraktuesi eshte _______________________________________________________

**Neni 2 Sigurimi i kontrates**

2.1 Sigurimi i kontrates ne shumen prej *(10% te vleres se ofertes)* ____________________________________________ duhet te ofrohet nga Kontraktuesi per te siguruar ekzekutimin e detyrimeve te tij sipas kontrates.

2.2 Sigurimi i Kontrates do t'i leshohet ose kthehet, menjehere Kontraktuesit sipas formularit te meposhtem:
______________________________________________________________________
______________________________________________________________________
______________________________________________________________________

Open Procurement Albania
Public Health Sector

**Neni 3 Fillimi i Kontrates**

3.1 Zbatimi i kontrates duhet te filloje me __________. Nese nuk eshte specifikuar, zbatimi do te filloje ne daten qe Kontraktuesi nenshkruan formularin e kontrates.

**Neni 4 Vendndodhja e Sherbimeve**

4.1 Sherbimet do te kryhen ne:_________________________________________________
______________________________________________________________________
______________________________________________________________________
______________________________________________________________________

**Neni 5 Informacion qe duhet dhene nga Autoriteti Kontraktor**

5.1 Brenda 15 ditesh nga marrja e sigurimit te kontrates, Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit informacionin dhe dokumentat e meposhtme: _______________________
______________________________________________________________________
______________________________________________________________________
______________________________________________________________________

_____________________________________________________________________________

## Neni 6 Kerkesat e Raportimit

6.1 Gjate zgjatjes se kontrates, Kontraktuesi duhet te siguroje raporte per Autoritetin Kontraktor sipas formularit te meposhtem: ______________________________________________________
_____________________________________________________________________________
_____________________________________________________________________________

## Neni 7 Siguracioni i Pergjegjesise Profesionale

7.1 Perpara fillimit te zbatimit te kontrates, Kontraktuesi duhet te siguroje Autoritetin Kontraktor me prova per siguracionin e pergjegjesise profesionale me shume minimale si vijon:________
_____________________________________________________________________________
_____________________________________________________________________________

## Neni 8 Kushtet e Pageses

8.1 Pagesa per Sherbimet duhet bere sipas skedarit te meposhtem:_______________________
_____________________________________________________________________________
_____________________________________________________________________________
_____________________________________________________________________________

Open Procurement Albania

8.2 Çdo pagese e skeduar duhet bere brenda _________ diteve nga data e arritjes se marrveshjes per pagesen ose nga data e marrjes se kerkeses me shkrim per pagese cilado qe te jete me vone. Nese eshte lene e paplotesuar, periudha kohore do te jete 30 dite.

8.3 Monedha e pageses do te jete ______. Nese eshte lene e paplotesuar, pagesa do behet me monedhen Shqiptare.

Public Health Sector

## Neni 9 Pagesa Paraprake

9.1 Perqindja e pageses paraprake do te jete _____. Nese eshte lene e paplotesuar, Kontraktuesi nuk do te marre pagese paraprake.

9.2 Nese eshte premtuar nje pagese paraprake, avanca do te paguhet brenda ______ diteve nga marrja e sigurimit te kontrates.

9.3 Nese jepet pagesa paraprake, shuma do te hiqet nga pagesa qe duhet t'i jepet Kontraktuesit sipas formules se meposhtme:________________________________________________
_____________________________________________________________________________

## Neni 10 Zbritja e garancise se kontrates

10.1 Nese parashikohet zbritje periodike te garancise se kontrates ajo kryhet si me poshte
_____________________________________________________________________________
__________________________________________________________________

Nese nuk plotesohet, garancia mbetet e pandryshuar.

**Shtojca 18**

[ Shtojce per t'u plotesuar nga Autoriteti Kontraktor]

**FORMULARI I PUBLIKIMIT TE NJOFTIMIT TE KONTRATES SE NENSHKRUAR**

**Seksioni I** **Autoriteti Kontraktor**

**I.1 Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor**

Emri ______________________________________________

Adresa ______________________________________________

Tel/Fax ______________________________________________

E-mail ______________________________________________

Adresa ne Internet ______________________________________________

**I.2 Lloji i autoritetit kontraktor:**

Institucion Qendror Institucion i Pavarur

Njesite e Qeverisjes Vendore Tjeter

Open Procurement Albania
Public Health Sector

**Seksioni 2** **Objekti i Kontrates**

**2.1 Numri i references se procedures/lotit__________**

**2.2 Lloji i "Kontratave Publike per Sherbime"**

Konkurs Projektimi Sherbime Konsulence Sherbime te tjera

**2.3 Kontrate ne baze te Marreveshjes Kuader**

Po Jo

**Nese Po, lloji i Marreveshjes Kuader**

**Me 1 Operator Ekonomik**

**Me disa operatore ekonomike**

**Te gjitha kushtet jane te percaktuara**

Po Jo

**2.4 Pershkrim i shkurter i kontrates**

1 Fondi limit ___________________________________________
2. Burimi i Financimit __________________________________________
3. Objekti i kontrates/marreveshjes kuader ___________________________________________

**2. 5 Kohezgjatja e kontrates ose afati kohor per ekzekutimin:**

Kohezgjatja ne **muaj ose dite**

ose

duke filluar nga // me perfundim ne //

**2.6 Ndarja ne LOTE:**

Po Jo

*Nese Po,* numri i LOTEVE*:*

Open Procurement Albania
Public Health Sector

**2.7 Opsionet:**

Numri i rinovimeve te mundshme(nese ka):

ose: nga ne

**2.8 Kontrate me nenkontraktim:**

Po Jo

**Seksioni 3 Procedura**

**3.1 Lloji i procedures:**

E hapur

**3.2 Kriteret e perzgjedhjes se fituesit:**
A) **çmimi me i ulet**

*ose*

B) **oferta ekonomikisht me e favorshme**

lidhur me rendesine: Çmimi **pike**

etj. **pike**

**3.3 Numri i ofertave te dorezuara:**

**Numri i ofertave te rregullta:**

**3.4. Gjate procesit te prokurimit ne fushen e Teknologjise te Informacionit dhe Komunikimit (TIK) jane perdorur standartet e pergatitura nga Agjencia Kombetare e Shoqerise se Informacionit:**

Po Jo

**3.5. Gjate procesit te prokurimit ne fushen e Teknologjise te Informacionit dhe Komunikimit (TIK), ne rastin kur standartet jane te paaplikueshme, eshte marre miratimi paraprak nga Agjencia Kombetare e Shoqerise se Informacionit**

Po Jo

Open Procurement Albania
Public Health Sector

**Seksioni 4 Informacion mbi kontraten**

**4.1 Numri i Kontrates: _______________Data e Kontrates** //

**4.2 Emri dhe adresa e kontraktorit**

Emri ________________________________________

Adresa ________________________________________

Tel/Fax ________________________________________

E-mail ________________________________________

Adresa e Internetit ________________________________________

4.2.1 **Emri dhe adresa e nenkontraktorit/eve**

Emri ________________________________________

Adresa ________________________________
Tel/Fax ________________________________
E-mail ________________________________
Faqja e Internetit ________________________________

**4.3 Vlera totale perfundimtare e kontrates** *(duke perfshire lotet opsionet dhe nenkontraktimin)*:

Vlera ______________ *(pa TVSH)* Monedha __________
Vlera ______________ *(me TVSH)* Monedha __________

**4.3.1** Vlera totale **e nenkontraktimit : ____**

Vlera ______________ *(pa TVSH)* Monedha __________
Vlera ______________ *(me TVSH)* Monedha __________

**4.4 Informacione shtese**

________________________________________________________________
________________________________________________

Data e shperndarjes se ketij njoftimi //

Open Procurement Albania
Public Health Sector

**Shtojca 19**

[ Shtojce per t'u plotesuar nga Autoriteti Kontraktor per publikim ne Buletinin e Njoftimeve Publike]

**1.Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor**

Emri ______________________________________________

Adresa ______________________________________________

Tel/Fax ______________________________________________

E-mail ______________________________________________

Faqja ne Internet ______________________________________________

**2. Lloji i procedures:** ______________________________________________

**3. Objekti i kontrates/marreveshjes kuader**________________________

**4. Numri i references se procedures/lotit**___________________________

**5. Fondi limit** ______________________________________________

**6. Vlera totale perfundimtare e kontrates** *(duke perfshire lotet opsionet dhe nenkontraktimit)*:

Vlera ________________ *(me TVSH)* Monedha __________

Vlera e nenkontraktimit_______________*me Tvsh* Monedha

**7. Data e lidhjes se kontrates ____________**

**8. Emri dhe adresa e kontraktorit / nenkontratorit**

Emri ______________________________________________



Open Procurement Albania
Public Health Sector

Adresa ____________________________________________

Nr. NIPT ____________________________________________

**Shtojca 20**

[*Leter me koke e Bankes / Kompanise se Sigurimeve*]
[ *Shtojce per t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik*]

**FORMULARI I SIGURIMIT TE KONTRATES**

[Data ________

Per: *[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]*
Ne Emer te: *[Emri dhe adresa e ofertuesit te siguruar]*

Procedura e prokurimit: *[lloji i procedures ]*
Pershkrim i shkurter i kontrates: *[objekti]*
Publikimi *(nese zbatohet):* Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]*

Duke iu referuar procedures se lartpermendur, dhe me kusht qe [*emri i ofertuesit te percaktuar fitues*] t'i jete akorduar kontrata,

Ne vertetojme se [*emri i ofertuesit te percaktuar fitues*] ka derdhur nje depozite prane [*emri dhe adresa e bankes / kompanise se sigurimeve*] ne nje shume prej [*monedha dhe vlera, e shprehur ne fjale dhe shifra*] si kusht per sigurimin e ekzekutimit te kontrates, qe do te nenshkruhet me [*emri i autoritetit kontraktor*]

Marrim persiper te transferojme ne llogarine e [*emri i autoritetit kontraktor*] vleren e siguruar, brenda 15 (pesembedhjete) diteve nga kerkesa juaj e thjeshte dhe e pare me shkrim, pa kerkuar shpjegime, me kusht qe kjo kerkese te permende mos permbushjen e kushteve te kontrates.

Ky Sigurim eshte i vlefshem deri ne zbatimin e plote te kontrates.

Open Procurement Albania
Public Health Sector

[Perfaqesuesi i bankes / kompanise se sigurimeve]

**Shtojca 21**

## FORMULARI I ANKESES PRANE AUTORITETIT KONTRAKTOR

***Ankese drejtuar:*** ***Autoriteti Kontraktor***

**Seksioni I. Identifikimi i Ankimuesit**

*Ankimuesi mund te jete nje ofertues ose ofertues i mundshem (psh, si individ, ne partneritet, ne bashkepunim, ne bashkim shoqerish).*

Open Procurement Albania
Public Health Sector

Emri i plote i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

Adresa

Qyteti | Shteti | Kodi Postar/Kodi Zip

Nr. Telefoni (duke perfshire edhe prefiksin e zones) | Nr. Faksi (duke perfshire edhe prefiksin e zones)

E-mail

Emri dhe pozicioni i zyrtarit te autorizuar qe ploteson ankesen (ju lutem, shtypeni)

Firma e zyrtarit te autorizuar | Data (viti/muaji/dita)

Nr. Telefoni (duke perfshire prefiksin e zones) | Nr. Faksi (duke perfshire prefiksin e zones)

**Seksioni II. Informacion per Proceduren**

**1. Numer Identifikimi**

*Plotesoni numrin e kontrates ne njoftimin e kontrates ose ne dokumentat e tenderit, duke perfshire* ***llojin e procedures se perdorur*** *per prokurimin ne fjale (psh, Kerkese per Propozime(KP), Procedure e Hapur(PH), Procedure e Kufizuar(PK), Procedure me Negociim(PN), Sherbim Konsulence (SHK), Konkurs Projektimi (KP).*

**2. Autoriteti Kontraktor**

*Emri i autoritetit kontraktor qe administron procesin e prokurimit.*

**3. Vlera e Perllogaritur e Prokurimit**

*Llogaritja e vleres se kontrates (shuma e shprehur ne shifra dhe fjale)*

Open Albania
Public Health Sector

**4. Objekti i Kontrates**

*Pershkrim i shkurter i puneve/mallrave/sherbimeve qe blihen.*

**5. Afati Perfundimtar per Dorezimin e Ofertes**

*Afati perfundimtar per dorezimin e ofertave.*

Data (viti/muaji/dita)

**6. Data e Percaktimit te Kontrates Fituese**

Data (viti/muaji/dita) nese zbatohet

**Seksioni III. Pershkrimi i ankeses**

**1. Baza Ligjore e Ankeses**

(shkruani shkeljen ligjore, bazuar ne vendime, akte, dokumenta, etj)

**2. Deklarate e Hollesishme e Fakteve dhe Argumenteve**

*Jepni nje deklarate te hollesishme te fakteve dhe argumenteve qe mbeshtesin ankesen tuaj. Per çdo arsye te ankeses specifikoni daten ne te cilen u vute ne dijeni per faktet e lidhura me arsyet e ankeses. Permendni edhe seksionet perkatese te dokumentave te tenderit, nese zbatohen. Perdorni faqe shtese, nese eshte e nevojshme.*

**3. Lista e Shtojcave**

*Qe nje ankese te konsiderohet e dorezuar, ajo duhet te jete e plote. Bashkangjisni nje kopje te lexueshme te te gjithe dokumentave qe kane lidhje me ankesen tuaj dhe nje liste te te gjithe ketyre dokumentave. Dokumentat duhet te perfshijne normalisht* ***çdo njoftim te publikuar, te gjitha dokumentat e tenderit, me te gjitha ndryshimet dhe shtojcat, propozimin tuaj .*** *Percaktoni se cili prej informacioneve eshte konfidencial, nese ka te tille. Shpjegoni se perse informacioni eshte i tille, ose dorezoni nje version te dokumentave perkatese me pjeset konfidenciale te hequra dhe nje permbledhje te permbajtjes.*

Open Albania
Public Health Sector

Dergojeni formularin e plotesuar te ankeses per prokurimin, te gjitha shtojcat e nevojshme dhe disa kopje shtese, prane **autoritetit kontraktor**

Shenim: Per ankesat prane Komisionit te Prokurimit Publik duhet t'i referoheni Formularit te Ankeses se nxjerre nga ky institucion.

**Nr. Faks:**
**E-mail:**

**Nenshkrimi dhe Vula e ankuesit**

**Shtojca 22**

**DRAFTI I MARREVESHJES KUADER**

( KU TE GJITHA KUSHTET JANE TE PERCAKTUARA)

**PER PUNE / MALLRA / SHERBIME**

[Perdorimi i ketij draft marreveshje eshte detyruese per te gjitha Autoritetet Kontraktore qe do te perdorin marreveshjen kuader)

**Nr __**

**DATA:**

Kjo kontrate lidhet [*data*], midis [*emri dhe adresa e Autoritetit Kontraktor*] tani e tutje te referuar si "Autoriteti Kontraktor" dhe [*emri dhe adresa e Kontraktuesit*] te perfaqesuar nga [*perfaqesuesi*], tani e tutje i quajtur si "Kontraktuesi".

Kontraktori, me ane te ofertes se tij, me date [*data*] bie dakord te furnizoje mallrat, ashtu siç jane te specifikuara ne kushtet e percaktuara ne:

- Kete kontrate
- Formulari i Deklarimit te Ofertes, te paraqitur nga Ofertuesi
- Specifikimet Teknike
- Formulari i çmimit te ofertes

❑ Te gjitha keto dokumenta te bashkangjitur perbejne pjese integrale te kesaj kontrate.

Open Procurement Albania
Public Health Sector

**Neni 1 Objekti**

1.1 Objekti i marreveshjes kuader eshte te percaktoje kushtet, perfshire çmimet per njesi dhe rregullat per dorezimin e mallrave/sherbimeve/puneve ne vijim.

[pershkrimi i pergjithshem]

1.2 Marreveshja kuader do te zbatohet me dergimin e ftesave per oferte tek operatoret ekonomike, pale ne marreveshje. P.sh. kurdohere qe Autoriteti Kontraktor i perfshire ne kete marreveshje, do te bleje artikuj ne baze te kesaj kontrate, duhet qe te dergoje "ftesen per oferte" tek kontraktuesi, duke specifikuar listen me artikuj per furnizim me sasite e tyre perkatese.

1.3 Sasite e parashikuara, jane vetem sasi orientuese dhe NUK e kushtezojne Autoritetin Kontraktor per t'i blere ato. Autoriteti Kontraktor ka te drejte te bleje me pak apo me shume sasi se sa ato te parashikuara.

1.4 Kontraktuesi nuk do te kete te drejte kompensimi dhe NUK do t'i lejohet te beje ndryshime te çmimeve te njesise, per shembull ne rast se autoriteti kontraktor vendose te bleje me pak apo me shume sasi se sa ato te specifikuara dhe/ose ne rast se autoriteti kontraktor vendos te mos bleje asnje nga keto sasi per disa artikuj.

1.5 **Kohezgjatja e marreveshjes kuader**

_______________________

**Neni 2 Çmimi**

2.1 Çmimet per njesi per pune/mallra /sherbime jane treguar ne Formularin e Cmimit te Ofertes.

2.2 Çmimet e njesive duhet te jene fikse dhe nuk duhet t'i nenshtrohen ndryshimeve per porosite e vendosura ne kete marreveshje kuader.

**Nenshkrimet dhe Datat**

| **Per Kontraktuesin** | | **Per Autoritetin Kontraktues** | |
|---|---|---|---|
| **Emri:** | | **Emri:** | |
| Pozita: | | Pozita: | |
| Nenshkrimi: | | Nenshkrimi: | |
| Data: | | Data: | |
| **Vula:** | | **Vula:** | |

Open Procurement Albania
Public Health Sector

**Shtojca 23**

## DRAFTI I MARREVESHJES KUADER

## ( KU JO TE GJITHA KUSHTET JANE TE PERCAKTUARA)
## PER PUNE / MALLRA / SHERBIME

**Emri i Autoritetit Kontraktor,**

Dhe

**Emri i Kontraktuesit**

Bien dakord si vijon:

**Te nenshkruajne kete marreveshje kuader per objektin:** < vendosni titullin > me numrin identifikues : *<vendosni Numrin e Prokurimit>*

### Neni 1 Objekti

1.1 Objekti i kesaj marreveshje kuader eshte te vendose rregullat per kontratat te cilat do te lidhen permes procesit te mini-konkursit vetem ndermjet operatoreve ekonomike qe jane pale e kesaj marreveshje kuader.

1.2 Kjo marreveshje kuader nuk eshte nje kontrate ne vete por percakton kushtet per kontratat qe do te lidhen ne baze te saj.

1.3 Kontraktuesi eshte vetem nje nga palet e marreveshjes kuader.

Open Procurement Albania
Public Health Sector

### Neni 2 Detyrimet e Paleve

2.1 Autoriteti Kontraktues, pale ne kete marreveshje, do t'i dergoje kontraktuesit "Ftesen per Oferte" kurdo qe paraqitet nevoja per pune/mallra/sherbime.

2.2 Kontraktuesi, detyrohet te dorezoje nje oferte kurdo qe kerkohet nga Autoriteti Kontraktor.

### Neni 3 Kontratat ne zbatim te marreveshjes kuader

3.1 Kontratat do te nenshkruhen vetem pas procesit te mini-konkursit.

### Neni 4 Procesi i mini-konkurrences

4.1 Procesi i mini- konkursit do te kryhet me te gjithe operatoret ekonomike, pale ne marreveshjen kuader, kurdohere qe paraqitet nevoja per pune /mallra/sherbime per Autoritetet Kontraktore.

4.2 Autoriteti Kontraktor do te ri-hape konkursin ne baze te kushteve te njejta ose te kushteve te tjera te vendosura ne ftesen per oferte, sipas percaktimeve ne dokumentat e tenderit.

4.3 Kurdohere qe paraqitet nevoja per pune/mall /sherbim Autoriteti Kontraktor duhet te pergatise Ftesat per Oferte dhe t'ua dergoje te gjithe operatoreve ekonomike, pale ne marreveshjen kuader. Vleresimi i ofertave do te behet sipas kritereve te percaktuara ne Ftesen per Oferte.

**Neni 5 Kohezgjatja e marreveshjes kuader**

___________________________________

**Nenshkrimet dhe datat**

| **Per Kontraktuesin** | | **Per Autoritetin Kontraktues** | |
|---|---|---|---|
| **Emri :** | | **Emri:** | |
| Pozita: | | Pozita: | |
| Nenshkrimi: | | Nenshkrimi: | |
| Data: | | Data: | |
| **Vula:** | | **Vula:** | |

**Shtojca 24**

[ *Shtojce per t'u plotesuar nga Autoriteti Kontraktor*]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TE ANULIMIT**

**1.Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor**

Emri ____________________________________________

Adresa ____________________________________________

Tel/Fax ____________________________________________

E-mail ____________________________________________

Faqja ne Internet ____________________________________________

**1. Lloji i procedures:** ________________________________________

**2. Numri i References:** ________________________________________

**3. Objekti i kontrates** ________________________________________

**4. Fondi limit** ________________________________________

**5. Arsyet e Anulimit:**

Bazuar ne Ligjin Nr. 9643, date 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik" i ndryshuar, neni 24, pika 1:

**a)** ;

**b)** ;

**c)** ;

**ç)** ;

**d)** ;

**dh)** ;

**Etj.** ________________________________________

**6. Informacione shtese**

________________________________________________________________

________________________________________________________________

Data e shperndarjes se ketij njoftimi _